

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7685 E shtunë 20 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

Vitin e kaluar, fjala "post-truth" u shpall fjala e vitit nga fjalori i Oksfordit në garë të ethshme me "Lajmet e rreme" (fake news). Në fakt, fabrikimet dhe lajmet...

Vijon në faqen 20

Nga ILIR KALEMAJ

Lajme të rreme apo autoritarizëm i maskuar



Opinion **Ditës**

Raporti i fundit i Kontrollit të Lartë të Shtetit në Komisionin e Ekonomisë për zbatimin e Buxhetit të Konsoliduar të Shtetit për vitin 2017 jep një pasqyrë...

Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

Sikur opozita të thellohej në raportet e KLSH!



E zbulojnë gazetatat, Athina zyrtare e mohon

Skandali, qeveria greke, fond sekret miliona euro për mediat në Shqipëri

Ministri i Mbrojtjes, Kamenos akuzon Kotzias: Shpërdorim i fondit 43 milionë euro të ministrisë

Nga VALENTINA MADANI
Athina zyrtare ka financuar me miliona euro media dhe gazetare shqiptarë, gjë që ka provokuar një debat të ashpër në Greqi. Ministria e Jashtme greke financonte me fonde sekrete media dhe gazetare në Shqipëri "për të siguruar publikime pozitive rreth..."

SUPEROPERACIONI/ SHKATERROHET GRUPI KRIMINAL ME MBI 20 VETE NGA SHQIPERIA E KOSOVA

ZBULOHET LABORATORI ME 100 KG HEROINE, 5 NE PRANGA

Policia mësyn në Has, kapet edhe opium. Dëshmitarët: Fshati u vu në shtetrrëthim. 3 të arrestuar nga familja Shutit. Bosët e vërtetë, të panjohur



(Në foto) Laboratori i drogës në fshatin Brenog të Hasit. Flamur Bisho Çela, zjarrfikës në Shkodër

DIPLOMACI

Turqia kërkon në Tiranë ekstradimin e gylenistëve, Bushati: Jemi vend i NATO-s

Në faqet 4

RREZIKU NGA PEDOFILIA

Raporti europian: Mbi 5 mijë fëmijë shqiptarë të trafikuar në vite

Në faqen 9

FOTOT E TOTIT

Nuk paraqitet në gjykatë, gjobitet me 250 euro trajneri i Kombëtares, Panuçi

Në faqen 22

"UNIVERSITET MADHESHTOR"



Eksperti amerikan, leksion të hapur te "Luarasi": Jam i impresionuar

Në faqen 5



Këngëtari mbetet në qeli për armë dhe drogë. I kërkoi shokut të hiqte gjurmët

"E gjujta at' senin", dalin përgjimet e Stresit

Biseda, reperi i kërkoi ndihmë Bajrëve për të dalë jashtë vendit

Nga KLODIANA LALA

Arkimede Lushajt do t'i aduhet të përballet me drejtësinë nga brenda qelisë, lidhur me akuzat për armë dhe drogë. Reperi i njohur, Stresi, nuk ka mundur të lërë burgun brenda 48 orëve, pasi gjykata ka vendosur të

pranojë të ligjshëm arrestimin e policisë, nisur nga provat e paraqitura nga organi i akuzës. Në dosjen në ngarkim të 31-vjeçarit Lushaj, prokuroria ka zbardhur përgjimet telefonike të tij, përgjime që datojnë në periudhën 26 qershor 2018 deri më...

Në faqen 7

"BLUETOOTH"

Arrestimi i Stresit, ja si reagon Kejsi. Kledi Kadiu flet për martesën

Suplement

OPERACIONI ANTIDROGE ARRESTIMET

"Policia e mori Mustafë Shutin zvarrë për krahësh. Janë sekuestruar 260 kg drogë"

"Kemi ngelur pa gojë, e kujt i shkonte mendja se në fshat kishte laborator heroine"

Banorët: Jemi në shtetrrëthim si në kohë lufte, të terrorizuar nga ajo që po ndodh

Trëndafille Visha

HAS

Jemi të shokuar nga ajo që po ndodh që prej ditësh në fshatin tonë. Burra, gra, fëmijë kanë mbetë pa gojë. Pasditën e së enjtes u habitëm kur pamë se po vinin forca të shumta policie. U rrethua fshati cep më cep dhe matanë tij. Nisën kontrollët, ndërsa askush prej nesh nuk e dinte se çfarë po ndodhte. E kujt i shkonte mendja se në fshat ishte ngritur një laborator heroine. Terror, terror gjithandej. Një bashkëfshatarin tonë e mori policia zvarrë për krahësh. Është mbi 80 vjeç". Kështu u shprehën djegë banorët e fshatit Brenog të Hasit. Fshat ky që ndodhet rreth 12 km nga qyteti i Krumës. Vetëm disa orë pas fillimit të operacionit, banorët kanë mësuar se në fshatin e tyre "luhej" drogë e madhe. Ata ende nuk mundën ta besojnë se Mustafë Shuti, djali i tij, Xhevit dhe nipi 15-vjeçar është përfshirë në këtë histori që sipas tyre ka kapërcyer kufijtë e Hasit. Ndërkaq, banorët u shprehën për "Gazeta Shqiptare" se janë shumë të frikësuar dhe sidomos fëmijët, të cilët kanë parë nëpër fshat persona me uniformë (disa me mbishkrimin DEA), të armatosur dhe me "maska" në fytyrë. Ndonëse të trembur tejet, ata treguan me detaje mbi superoperacionin antidrogë që nisi dy ditë më parë dhe që po vazhdon në zonën e tyre.

RRËFIMI I BANORËVE

"Ka qenë ora 14:00, kur në rrugën e fshatit pamë të vlin shumë policë. Fillimisht, u habitëm dhe filluam të pyesnim njëri-tjetrin se çfarë ka ndodhur. Më pas shtangëm të gjithë, pasi policët



48-vjeçari i arrestuar, Xhevit Shuti

"SHTETRRËTHIMI"

"Ka qenë ora 14:00, kur në rrugën e fshatit pamë të vlin shumë policë. Fillimisht, u habitëm dhe filluam të pyesnim njëri-tjetrin se çfarë ka ndodhur. Më pas shtangëm të gjithë, pasi policët rrethuan gjithë fshatin. Gratë dhe fëmijët na pyesnin se ç'po ndodh dhe ne nuk dinim t'u jepnim përgjigje. Nuk ka ndodhur më parë një gjë e tillë në fshatin tonë. Jemi bërë kaq sa jemi e s'kemi parë të vihat fshati në shtetrrëthim si me qenë kohë lufte", thanë disa banorë të fshatit Brenog.

Sekuestrohen armë e drogë, 5 të arrestuar e 2 në kërkim

TIRANË - Forca e Ligjit ka goditur dy raste të armëbajtjes pa leje dhe katër raste të shpërndarjes së lëndëve narkotike, ndërsa në pranga kanë përfunduar 5 persona. Gjatë kontrollëve të ushtruara në lokale, ambiente, banesa dhe në akset rrugore të kryeqytetit për kapjen e personave në kërkim, u arrestuan 5 persona, përkatësisht: Premtim Qendro, 44 vjeç, banues në Tiranë, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në lokalitë e këtij shtetasi u gjet dhe bllokua në cilësinë e provës materiale 61 gr kokainë, 7 doza kanabis dhe një thikë; Baftjar Selimi, 54 vjeç, banues në Tiranë, pasi gjatë kontrollit



të ushtruar në fshatin Pitall, në banesën e tij u gjet dhe bllokua 2 kg e 147 gr kanabis; Ferit Xhani, 28 vjeç, banues në Tiranë, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në rrugën "Pjetër Budi", u gjet dhe bllokua në cilësinë e provës materiale 16 doza kanabis; Gerli Prifti, 21

vjeç, banues në Tiranë, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në rrugën "Pandit Dardha" u gjet dhe bllokua 6 doza kanabis si dhe Juljan Shullazi, 27 vjeç, banues në Vorë, pasi në Fushë-Prezë gjatë kontrollit të ushtruar të mjetit tip "Benz", u gjet dhe sekuestrua një pistoletë me një krehër me fishekë. Iu bllokua dhe mjeti në cilësinë e provës materiale. Ndërsa u shpall në kërkim për veprën penale "Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak", A.H., 39 vjeç, banues në Kamzë, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në banesë u gjet dhe sekuestrua një armë zjarri automatik dhe një krehër me sasi fishekësh.

për qind nuk e prisnim një gjë të tillë. E kujt i shkonte mendja. E për më tepër për Mustafë Shutin, të cilin e morën zvarrë për krahësh policët se është burrë i vjetër dhe mezi mbahet në këmbë. Ishanllah nuk u ngel në duar", pohoi një nga banorët. Ndërsa, një tjetër tre-



Laboratori i drogës në fshatin Brenog të Hasit

TAKIMI

Laboratori i heroinës në Has, ka mbledhur paraditen e djeshme në një takim drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ardi Veliu (shoqërohej nga kreu i Policisë Kriminale, Eduard Merkaç) dhe dy prokurorëve të Krimeve të Rënda, Vladimir Mara dhe Dritan Premçi. Burime nga organi i akuzës bëjnë me dije se në qendër të takimit ka qenë operacioni i policisë për laboratorin e sekuestruar në Has, por pa dhënë më shumë detaje. Policia lokale ka njoftuar se në ditët në vijim do të bëjë publike rezultatet.

DËSHMIA PËR DROGËN

Të pyetur në lidhje me laboratorin e heroinës, ata u shprehën: "Vetëm nga ora 22:00 e së enjtes u mor vesh se bëhej fjalë për drogë. Ne kemi mësuar se në atë laboratorin është sekuestruar jo 100 kg heroinë siç po dëgjojmë në lajme, por 260 kg. Ne një qind për qind nuk e prisnim një gjë të tillë. E kujt i shkonte mendja. E për më tepër për Mustafë Shutin, të cilin e morën zvarrë për krahësh policët se është burrë i vjetër dhe mezi mbahet në këmbë.



FRIKA

"Xheviti ka një autobus 12 vendesh dhe me të bën për çdo ditë linjën Durrës-Has. Jemi të habitur, të habitur. Nuk di çfarë të them për këtë. Policia e di punën e saj". Ndërkaq, banorët u shprehën se ndihen shumë të frikësuar dhe se ata nuk i kanë asnjë borxh policisë që t'i terrorizojë fshatçe. "A e kapi policia drogën? A i kapi personat që dyshohen se merreshin me drogë? Po ne çfarë faji kemi në këtë mes? I madh dhe i vogël në fshat është i frikësuar", thanë ata.



goi se edhe Xhevit Shuti, djali i Mustafës është kapur nga policia. "Xheviti ka një autobus 12 vendesh dhe me të bën për çdo ditë linjën Durrës-Has. Jemi të habitur, të habitur. Nuk di çfarë të them për këtë. Policia e di punën e saj". Ndërkaq, banorët u shprehën se ndihen

shumë të frikësuar dhe se ata nuk i kanë asnjë borxh policisë që t'i terrorizojë fshatçe. "A e kapi policia drogën? A i kapi personat që dyshohen se merreshin me drogë? Po ne çfarë faji kemi në këtë mes? I madh dhe i vogël në fshat është i frikësuar", thanë ata.

Superoperacioni, grupi kriminal me mbi 20 persona nga Shqipëria dhe Kosova

Zbulohet laborator i përpunimit të heroinës në Has, përfundojnë në pranga 5 persona

Sekuestrohen mbi 100 kg drogë dhe opium. Tre nga të arrestuarit, pjesëtarë të familjes Shuti



HAS

Afro tre vjet pas zbulimit të laboratorit të përpunimit të drogave të forta në Xibrakë të Elbasanit, një tjetër laborator droge është zbuluar dhe kësaj here në verilindje të vendit. Mësohet se laboratorit ishte ngritur në fshatin Brenog të Hasit, brenda dy kaponëve që shërbenin si stallë për bagëtitë. Mbi 100 kg heroinë e përpunuar si dhe një sasi e madhe opiumi është sekuestruar në këtë laborator gjatë një operacioni të madh që po zhvillohet që prej dy ditëve nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me blutë e Kukësit, forcat RENEa e FNSH si dhe agjentë të DEA-s amerikane. Gjatë këtij operacioni janë arrestuar 5 persona, ndërsa janë shoqëruar dhe po merren në pyetje dhe 8 persona të tjerë. Edhe pse burimet nga policia janë treguar të rezervuara, mësohet se dy nga personat e vënë në pranga janë Mustafë dhe Xhevit Shuti (babë e bir) si dhe Flamur Bisho Çela, shofer prej 26 vitesh tek reparti i zjarrfikësve në Shkodër. Ndërsa dy të arrestuarit e tjerë janë shtetasit me iniciale: V.B. dhe 15 vjeçari A. Shuti (djali i Xhevitit). Policia e Shtetit ka dhënë vetëm një njoftim të shkurtër, duke njoftuar se operacioni zhvillohet në bashkëpunim me agjencitë e huaja partnere dhe se dyshohet që laboratorit përdorej për prodhimin e drogave të forta. Operacioni është në zhvillim e sipër, ndërsa po kryhen kontrole në të gjithë zonën. Sipas informacioneve të siguruar nga "Gazeta Shqiptare", rezultojnë se zbulimi i laboratorit të heroinës në Has është bërë i mundur falë bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacioneve me autoritetet gjermane. Po sipas këtyre burimeve, operacioni do të shtrihet dhe në disa zona të tjera të vendit tonë.

LABORATORI I HEROINËS NË HAS
Ndonëse deri tani pjesa verilindore e vendit ishte lënë jashtë hartës së drogës, operacioni i fundit i policisë dhe forcave speciale vërtetoi të kundërtën. Pas informacioneve të siguruar për një laborator droge në Has, Policia e Shtetit ka ndërmarrë një operacion të gjerë në këtë zonë. Operacioni ka nisur që pasditen e së enjtes dhe është në vijim, pasi mësohet se ka dhe të tjerë persona të përfshirë në këtë aktivitet kriminal, përfshirë këtu dhe shtetas të huaj. Forca të shumta policore kanë mbërritur në fshatin në fjalë dhe kanë zbuluar e marrë në kontroll objektin ku bëhej përpunimi i heroinës. "GSH" ka siguruar pamjet e laboratorit të përpunimit të heroinës. Nga pamjet duket një shtëpi fshati mes pemëve që nuk ngjall dyshime. Ndërsa,



Droga e sekuestruar në Has



Flamur Bisho Çela, zjarrfikës në Shkodër



Policia e Kukësit: Objekti përdorej për përpunimin e drogave të forta

Pas lajmit të zbulimit të një laborator droge në Has, ka reaguuar zyrtarisht policia e Kukësit. Zyrtarisht bëhet e ditur se Drejtoria Vendore e Policisë Kukës në bashkëpunim me agjencitë e tjera ligjzbatuese dhe nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës kanë zhvilluar një operacion antidrogë ku është zbuluar një objekt që dyshohet se përdorej për përpunim të drogave të forta. "Për detaje të operacionit Policia e Shtetit, Prokuroria dhe agjencitë ligjzbatuese në ditë në vijim do të kenë një konferencë të përbashkët për mediat për operacionin që zhvillohet në qarkun e Kukësit", deklaroi policia. Ky operacion vjen një ditë pas paralajmërimit që ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, bëri gjatë konferencës së përbashkët për shtyp me kreun e policisë gjermane, kur tha se ditët në vijim do ketë zhvillime interesante. Operacioni në Has besohet se është zhvilluar në bashkëpunim me agjencitë partnere.

20 PERSONA
Burime të besueshme nga policia dje pohan se janë mbi 20 persona të përfshirë në rrjetin kriminal që merrej me përpunimin e heroinës në laboratorin që u zbulua në fshatin Brenog të Hasit. Mësohet se këtë grup bëjnë pjesë edhe disa shqiptarë nga Kosova.

- PERSONAT E ARRESTUAR**
1. Mustafë Shuti, 76 vjeç
 2. Xhevit Shuti, 48 vjeç (babë e bir)
 3. A. Shuti, 15 vjeç (djali i Xhevitit)
 4. Flamur Bisho, Çela, zjarrfikës në Shkodër
 5. V.B.

Laboratori i drogës, reagon kryeministri Rama: Beteja vijon pa kompromis, opozita e dëshpëruar

TIRANË - Kryeministri Edi Rama ka reaguar mbremë përmes një postimi në "Twitter" për operacionin e zhvilluar në Has, ku u zbulua një laborator i përpunimit të drogave të forta si dhe u arrestuan 5 persona.
Rama shprehet se në të gjithë botën operacionet kundër kimit e drogës quhen sukses, ndërsa në Shqipëri opozita sipas tij i



pranë banesës ishte dhe objekti tjetër që më parë kishte shërbyer si stallë bagëtitësh. Pikërisht në këtë "stallë" janë gjetur dhe sekuestruar mbi 100 kg heroinë e përpunuar si dhe një sasi e madhe opiumi që shërben si lëndë e parë për prodhimin e heroinës. Gjithashtu, janë sekuestruar dhe materiale të tjera që shërbenin për përgatitjen e lëndës narkotike si

dhe kokainë e kanabis.
ARRESTIMET
Paraprakisht mësohet se në operacionin e madh antidrogë kanë përfunduar në pranga 5 persona. Dy prej tyre janë babë e bir. Bëhet fjalë për Mustafë dhe Xhevit Shutin, banues në fshatin Brenog. Sipas burimeve policore, dyshohet që i moshuari Mustafë Shuti dhe djali i tij, Xhevit si dhe pjesëtarit tjetër i kësaj

fan faje të qeverisë.
Statusi i plotë i Ramës: "Në gjithë botën normale operacionet kundër kimit e drogës quhen sukses, në gjuhën e dëshpërimit opozitar ato quhen faje të qeverisë.
Operacioni i sotëm është një tjetër provë e qartë force e shtetit kundër kimit, në vazhdim e një beteje që do të vijojë pa kompromis."

PARALAJMËRIMI I XHAFAJT
Operacioni antidrogë i zhvilluar në Has u paralajmërua dy ditë më parë nga ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Paralajmërim ky i bërë dy ditë më parë gjatë konferencës së përbashkët për shtyp me kreun e policisë gjermane, Dieter Romann. Gjatë fjalës së tij, Xhafaj paralajmëroi gazetaret duke u thënë se në ditët në vijim do ketë zhvillime interesante.

përgatitjes së heroinës. Personi që krijoi laboratorin është një emër i njohur dhe është identifikuar nga policia. Ai është pjesë e një grupi kriminal në zonë mjaft të fuqishëm, të cilët kanë qenë aktiv vitet e fundit. Gjithashtu, mësohet se heroina përgatitje nga dy persona të huaj, të cilët ishin ekspertë në nxjerrjen e heroinës nga bima e opiumit. Ndërkaq, pritet të ketë arrestime të tjera, pasi operacioni i antidrogë është në vijim.

DIPLOMACIA REAGIMET

Çavusoglu: Mbyllni institucionet antiturke. Qeveria: Shteti shqiptar, jo pjesë e çështjeve fetare

Valentina Madani

Turqia sjell emrat, Shqipëria refuzon ekstradimin e "gülenistëve"

Bushati: Veprojmë si shteti i NATO-s dhe kandidat i BE-së

Mevlut Çavusoglu dhe Ditmir Bushati, takimin dje në Tiranë e nisën me një përfaqim të ngrohtë, por më pas çështja "FETO" duket se "ftoh" disi dy kryediplomatët, atë të Shqipërisë dhe Turqisë. Kjo, pasi Turqia i kërkon Shqipërisë të mbyllë institucionet antiturke në Shqipëri si dhe të ekstradojë elementët e organizatës "FETO", të njohur si gülenistë, por Tirana zyrtare dje refuzoi. Ministri i Jashtëm turk, Mevlut Çavusoglu deklaroi dje në Tiranë se vendi tij ka dorëzuar zyrtarisht listën me emrat e njerëzve të Fetulla Gülenit, që zhvillojnë aktivitetin në vendin tonë e që sipas tij janë të ngjitur deri në strukturat shtetërore. Por, ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati ia tha në sy homologut turk se Shqipëria do të respektojë dokumentet ndërkombëtare për këtë çështje, duke bërë të qartë se kjo rrugë ndiqet në rrugë diplomatike e jo konferenca shtypi. Në emër të Presidentit Erdoğan, ministri turk bëri të qartë se janë në pritje që Shqipëria të veprojë. "Ka një strukturë 'FETO' tepër serioze në Shqipëri në çdo fushë. Edhe si në vendet e tjera, kanë përdorur sistemin arsimor dhe kanë depërtuar shumë mirë brenda në sistemin shtetëror. Kjo organizatë terroriste është një kërcënim i hapur dhe i madh kundër Turqisë. E dimë që këtu ka elementë të 'FETO' dhe ne presim dëgjim nga Shqipëria mike. Presim që të mbyllin institucionet që zhvillojnë veprimtari antiturke në Shqipëri. Ata mund të bëjnë çdo gjë. Ne nuk strehojmë asnjë terrorist që mund të vijë nga Shqipëria. Këtë presim edhe nga miqtë tanë. I kemi dhënë listat me emrat e tyre dhe të personave për të cilët ne kërkojmë ekstradimin", - u shpreh Çavusoglu. Por, ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, edhe pse jo prerë, la të kuptohet se një hap i tillë nuk është në planet e qeverisë shqiptare, kur kujtoi të gjitha organizatat ku vendi ynë aderon dhe pret të aderojë. "Përgjigja e shtetit shqiptar është ajo përgjigje që i kemi dhënë qoftë Turqisë, por edhe në planin ndërkombëtar. Shqipëria ka qenë ndër vendet e para që është solidarizuar me çka ndodhi në Turqi në rrethanat e grushtit të shtetit, por nga ana tjetër është një vend anëtar i NATO-s, është një vend kandidat për në Bashkimin Europian. Ka aderuar në disa dokumente të rëndësishme ndërkombëtare



Mevlut Çavusoglu dhe Ditmir Bushati, gjatë takimit të djeshëm

Meta: Faleminderit Turqisë për mbështetjen dhe njohjen e Kosovës

Presidenti Ilir Meta priti dje ministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, Mevlut Çavusoglu. Gjatë takimit, Meta vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera midis dy vendeve dhe shprehu mirënjohjen për ndihmën dhe mbështetjen që Turqia i ka dhënë Shqipërisë dhe shqiptarëve, veçanërisht në tri dekadat e fundit. Duke u ndalur tek mundësitë e mëdha të bashkëpunimit ekonomik, Meta shprehu vlerësimin për vëmendjen që presidenti Erdogan dhe qeveria turke i kushtojnë këtij bashkëpunimi me Shqipërinë dhe nënvizoi se Turqia mbetet një nga partnerët kryesorë ekonomikë e tregtarë për Shqipërinë. Po ashtu, kreu i shtetit vlerësoi gjithashtu kontributin e dhënë nga Turqia përmes Agjencisë turke të Bashkëpunimit për Zhvillim TIKA, e cila tashmë është e pranishme në të gjithë Shqipërinë. Ndër të tjera, presidenti vlerësoi mbështetjen që Turqia ka dhënë për njohjen e pavarësisë dhe anëtarësimin e Kosovës në organizatat rajonale dhe ato ndërkombëtare.

mbëtare në fushën e ekstradimit. Dhe çdo politikë e tillë ndiqet në rrugë diplomatike dhe asesi në konferenca shtypi", u shpreh z.Bushati. Kryediplomati turk nuk e pohan lajmin se vendi tij e ka kushtëzuar inaugurimin e xhamisë së re të Namazgjasë, me largimin nga drejtimi i Komunitetit Mysliman të Skënder Brucajt. Ndërsa, ministri Bushati nxiton që të përforcojë se këto lajme janë spekulime mediatiqe. "Në median shqiptare por jo vetëm ka pasur lloj-lloj spekulimesh mbi këtë çështje. Në fakt, është ai qëndrim i njohur që ka të bëjë me AND-në

e kombit shqiptar, me parimin e laicitetit, që ishte parimi udhërrëfyes i rihlindasvetanë, kësajsoj do të ishte absurde të mendohej që shteti shqiptar mund të përfshihet në çështjet fetare e jo më një vend i huaj, qoftë edhe një vend mik siç, është Turqia", deklaroi ministri Bushati.

DITMIR BUSHATI

"Shqipëria ka qenë një nga vendet e para që është solidarizuar me çfarë ndodhi në Turqi, në rrethanat e grushtit të shtetit, por nga ana tjetër është vend anëtar i NATO-s, kandidat për në BE. Ka aderuar në disa dokumente të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e ekstradimit dhe çdo politikë e tillë ndiqet në rrugë diplomatike dhe asesi në konferenca shtypi", - tha Bushati.



Parlamenti i Greqisë

MEVLUT ÇAVUSOGLU

"Është e dobishme të shikohet si funksionon kjo organizatë 'FETO'. Ajo bëri një grusht shteti në Turqi. Presim që të mbyllin institucionet që zhvillojnë veprimtari antiturke në Shqipëri. Ata mund të bëjnë çdo gjë. Ne nuk strehojmë asnjë terrorist që mund të vijë nga Shqipëria. Këtë presim edhe nga miqtë tanë. I kemi dhënë listat me emrat e personave që ne kërkojmë të ekstradohen", u shpreh Çavusoglu.

Presidenti turk, Erdogan, së shpejti në Tiranë

Ruçi takon Çavusoglu: Bashkëpunim mes dy vendeve për çështjet e sigurisë

Gjatë vizitës së tij zyrtare në Shqipëri, ministri i Jashtëm i Turqisë, Mevlut Çavusoglu zhvilloi dje një takim me kreun e Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi. Kryeparlamentari shqiptar theksoi se marrëdhëniet e Shqipërisë me Turqinë janë strategjike, për shkak të lidhjeve historike, bashkëpunimit intens politik, partneritetit të ngushtë në NATO, shkëmbimeve të përgjithshme dinamike si edhe pozitës së dy vendeve në rajon. Z.Ruçi vlerësoi zërin e Turqisë në NATO për institucionalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Aleancës, si një premisë themelore drejt paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm në rajon si edhe kontributin e saj si lobuese e fuqishme në njohjen e Kosovës dhe anëtarësimin e saj në Interpol dhe institucione të tjera ndërkombëtare. Ministri Çavusoglu vlerësoi



Kosovës në Interpol. Ministri Çavusoglu vlerësoi bashkëpunimin midis të dy vendeve dhe nënvizoi se është në këtë vizitë për ta intensifikuar këtë bashkëpunim dhe për të përgatitur vizitën e Presidentit të Turqisë, Erdogan në Shqipëri. Çavusoglu theksoi se Shqipëria ka mbështetjen e plotë të Turqisë për kryesimin e OSBE-së në vitin 2020. Turqia punon gjithashtu për rritjen e njohjes ndërkombëtare të Kosovës dhe anëtarësimin e saj në Interpol dhe institucione të tjera ndërkombëtare. Ministri Çavusoglu vlerësoi

mbështetjen e Shqipërisë në luftën kundër terrorizmit dhe shprehu pritshmëritë ndaj Shqipërisë për qëndrimin ndaj organizatës terroriste FETO. Kryetari i Kuvendit, z.Ruçi nënvizoi se Shqipëria e mirëkupton këtë shqetësim të Turqisë dhe organet ligjzbatuese në Shqipëri e kanë në qendër të vëmendjes, duke bashkëpunuar edhe me organet homologe turke. Kurse kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi, deklaroi: "Shqipëria qëndroi që në çastet e para të tentativës për grusht shteti, në mbështetje të shtetit dhe qeverisë turke kundër çdo forme dhune e tentativës për prishjen e rendit demokratik. Mbetemi të hapur dhe jemi të gatshëm të bashkëpunojmë përmes institucioneve përkatëse të të dyja vendeve për shqetësime serioze të natyrës së sigurisë".

STRATI Shoqëria përbarimorë "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shlyerjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

-Regjistruar në Regjistrin hipotekor me Nr. 2035, datë 09.07.2007, Zona Kadastrale me Nr. 2460, Apartament (3+1), Nr. 22, me sipërfaqe 136 m², Seksioni Nr. 1, i ndodhur në katin e katit të Godinës së banimit dhe shërbimit 4-7-s katëshe plus një kat parkim, Linzë, Komuna Dajt, Tiranë, regjistruar në pronësi të Shoqërisë "Eurovini" Sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 52.584 Euro. **Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 26.10.2018.**

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

STRATI Shoqëria përbarimorë "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shlyerjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

-"Apartament Nr. 37", me sipërfaqe 69.7 m², i ndodhur në katin e pestë, seksioni i dytë të godinës 8 katëshe, në Linzë, Komuna Dajt, Tiranë, Regjistruar në Regjistrin Hipotekor me Nr. 2099, datë 09.07.2007, Zona Kadastrale 2460, regjistruar në pronësi të EuroVini sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 27.880 Euro. **Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 24.10.2018.**

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com



Ministri i Mbrojtjes, Kamenos, akuzon Kotziasin: Shpërdorim i fondit 43 milionë euro të ministrisë

Skandali, qeveria greke, fond sekret miliona euro për mediat në Shqipëri

Lobimi, përfituese edhe kisha ortodokse

Valentina Madani

Athina zyrtare ka fi nancuar me miliona euro media dhe gazetë shqiptarë, gjë që ka provokuar një debat të ashpër në Greqi. Ministria e Jashtme greke financoje me fonde sekrete media dhe gazetare në Shqipëri "për të siguruar publikime pozitive rreth Greqisë, për krijimin e lobit të gazetarëve shqiptarë në vend, si dhe që kokat e medias të mbështesin interesat e Greqisë". Sipas mediave greke, Ministria e Jashtme të këtij vendi vetëm për muajin tetor të këtij viti ka paguar 1 milion euro për portalet dhe mediat në Shqipëri. Skandali është zbuluar nga media "online" greke "Iefimerida" nga gazetari Dimitris Takis, ndërsa Prokuroria e Athinës ka nisur hetimet për nxjerrje të sekretit shtetëror. Sipas "Iefimerida", një javë para këtij debati, në 10 tetor, ka kaluar për miratim në parlamentin grek dokumenti i klasifikuar sekret me tri kode. Shuma e përgjithshme e fondit thuajse 1 milion euro ishte ndarë për pagesa në median në Shqipëri dhe për median në Maqedoni, ndërsa një fond tjetër për mbështetje e kishave ortodokse e ortodoksisë në përgjithësi. Për sa u përket shumave për median në Shqipëri, në reportazh theksohet se deputetëve iu dha shpjegimi: "Për të siguruar publikime pozitive për imazhin e Greqisë e krijimin e lobit të gazetarëve shqiptarë në vend, si dhe kokat e medias të mbështesin interesat e Greqisë". Ministria e Jashtme e Greqisë nuk ka përcaktuar se ku konkretisht janë shpërndarë këto para në Shqipëri. Ndërkaq, si kryetari i parlamentit grek, ashtu edhe Kryeministria greke kanë reaguar kundër reportazhit, duke u referuar secila palë në transparencën e punës së Kotzias dhe të drejtës së fondeve sekrete, por nuk kanë mundur të përgjeshetrojnë dokumentin konkret dhe fondin e investuar për mediat. Debat i Kamenos-Kotzias, nisur nga ky i fundit ka nxjerrë në pah edhe akuzën e Kamenos, se janë dhënë 45 milionë euro nga fondacioni "Soros" për mbylljen e marrëveshjes së Prespës. Ka qenë pikërisht ky akuzë dhe reagimi neutral i kryeministrit Tsipras që shkaktuan nervozizëm të ministri Kotzias, i cili e konsideron shpifje dhe sulm politik. Së



BESNIK MUSTAJA
"Kjo është e rëndë, pasi cenohet pavarësia e mediave në Shqipëri dhe ndërhyrje e rëndë në jetën demokratike. Heshnja e ministrit të Jashtëm shqiptar është e rëndë. Duhet të ketë një hetim kompleks lidhur me akuzat për financimin e mediave nga fonde sekrete i Ministrisë së Jashtme greke në Shqipëri, sepse kjo ka të bëjë me sigurinë kombëtare. Duhet të ketë një hetim nga prokuroria dhe duhet qëndrim nga qeveria", - tha Mustajaj.

KRYEMINISTRIA

Ministria e Jashtme greke financoje me fonde sekrete media dhe gazetare në Shqipëri "për të siguruar publikime pozitive rreth Greqisë, për krijimin e lobit të gazetarëve shqiptarë në vend, si dhe që kokat e medias të mbështesin interesat e Greqisë". Por qeveria greke e mohoi dje një gjë të tillë.

"Euro për mediat shqiptare", prokuroria e Athinës nis hetimet

Prokuroria e Athinës ka urdhëruar nisjen e hetimeve lidhur me informacionet e publikuara në gazetën elektronike greke "Iefimerida.gr", në lidhje me fondet sekrete dhe pagesat në median dhe biznese në Shqipëri dhe Greqi. Ndërkaq, pas bujës së shkaktuar për listën e gazetarëve dhe portaleve shqiptare që kryenin propagandë pro Greqisë, kryeministria greke e ka përgjeshëtruar zyrtarisht, duke theksuar se nuk janë shpërndarë fonde në media ballkanike. Sipas prokurorisë, publikimi në media i informacioneve sekrete të shtetit përbën akt penal dhe kriminal.

Bushati: Dorëheqja e Kotzias nuk pengon bisedimet me Greqinë

Dorëheqja e ministrit të Jashtëm grek, Nikos Kotzias, nuk e pengon vijimin e bisedimeve për çështjet e hapura mes Shqipërisë dhe Greqisë. Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, gjatë një konference për shtyp dje me homologun turk, Mevlut Cavusoglu u shpreh se, "ministri ikin e vijnë, e rëndësishme është që problemet të zgjidhen". "Raportet mes Shqipërisë dhe Greqisë janë përmirësuar ndjeshëm vitet e fundit dhe besoj se do të vijojmë të jemi në tryezën e bisedimeve me Greqinë për të mbyllur çështjet e hapura të cilat, siç e kam thënë disa herë, e kanë origjinën nga Lufta e Dytë Botërore e deri më sot", theksoi Bushati.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA NR. 2/69+2-14, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 8, FAQE 218, SIPERFAQE 85 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONESI TË z. ILMI SULA.

ÇMIMI 5.900.000 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 14.11.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Blerja nga Greqia, paralajmërimi i kreut të PDIU-së

Idrizi: Para të pista në media e portale kundër çështjes çame e pro interesave greke

Pas publikimit të lajmit se Ministria e Jashtme greke kishte financuar portale dhe gazetare në Shqipëri për lajme pro Greqisë, kreu i PDIU-së publikoi dje një video të muajit janar, sipas të cilit paralajmëroi shqiptarët për "fondet e pista", që hidheshin nga shteti grek kundër çështjes çame. Në janar të këtij viti, kryetari i PDIU-s, Shpëtim Idrizi paralajmëroi shqiptarët për fondet e pista që hidheshin në media e portale kundër çështjes çame e pro interesave greke, nga fondi sekret i Ministrisë së Jashtme greke. "Unë e di shumë mirë që influenca e Greqisë është e madhe edhe në mediat shqiptare. Shqipëria sot dhe çdo ditë do të jetë akoma edhe më e fortë, e mos u mban tek ata që tradh-



tojnë interesat e Shqipërisë", deklaroi Idrizi para disa muajsh. Botimi "bombë" që bëri pak ditë më parë gazetari grek, Dhimitris Takis, në gazetën elektronike "Iefimerida.gr" shkruante se Ministria e Jashtme greke financoje me fonde sekrete media dhe gazetare në Shqipëri "për të siguruar publikime pozitive rreth Greqisë, për krijimin e lobit të gazetarëve shqiptarë në vend, si dhe kokat e medias të mbështesin interesat e Greqisë". Ministria e Jashtme e Greqisë nuk ka përcaktuar se ku konkretisht janë shpërndarë këto para në Shqipëri.

fundi, ministri Kamenos ka akuzuar hapur dhe gazetën "Efimerida ton syntakton" për propagandë me fonde të "Soros". Mësohet se kur anëtarët e komisionit kanë kërkuar detaje për arsyen e harxhimit të shumave të mëdha për mediat shqiptare dhe maqedonase, nga ana e zyrtarëve të Ministrisë së Jashtme u është thënë se kjo bëhet për lobim të interesave greke në ato vende. Sipas Ministrisë së Jashtme greke:

"Paguajmë gazetarë ose botues të mediave edhe në Shqipëri, në mënyrë që të ketë shkrime pozitive për Greqinë ose të lobojnë në vendin e tyre në favor të interesave greke". Publikimi i lajmit solli reagime të fortë në Greqi, nga të cilat ai është vërtetuar indirekt. Kreu i parlamentit grek, Niko Vutçis deklaroi se është i indinjuar nga rrjedhja nëpër media e këtyre lajmeve për "shpenzime sekrete". Dorëheqja e Nikos

Kotzias nga drejtimi i Ministrisë së Jashtme erdhi pas debateve me ministrin e Mbrojtjes dhe njëkohësisht kryetarin e partisë bashkëqeverisëse ANEL, Panos Kamenos. Një nga temat e debatuar kanë qenë akuzat e Kamenos ndaj Kotzias për shpërdorimin e fondeve sekrete të Ministrisë së Jashtme, nga ku tashmë del që me miliona euro shpenzohen çdo vit për të financuar media e gazetare shqiptarë.

VETINGU
DEBATI

Opozita braktis mblledhjen: Po bëni si ata që lindin vajzë e pastaj thërrasin dasmën

Valentina Madani

Vetingu, Ruçi: Ndryshimet kushtetuese duan kohë, Boçi: Konsultimet, farsë

"Krimi buron nga politika, edhe akademikët të kapur"

Vetingu i politikanëve përplasi sërish dje mazhorancën dhe opozitën duke thëlluar ndasitë edhe në komisionin legjislativ. Për opozitën, vetingu në politikë ose pranohet nga mazhoranca ose rrëzohet. Sipas demokrateve konsultimet publike të Kuvendit me aktorë të ndryshëm të shoqërisë janë farsë. Këtë qëndrim mbajti deputeti demokrat, Luçiano Boçi, dje përpara se të largohej nga salla ku akademikët kishin ardhur për të dhënë mendimin e tyre për këtë propozim të opozitës. "Ju këtë punë do të bëni se doni ta shtyni. Se kur doni një ligj ju, e fusni nën tavolinë dhe e votoni brenda ditës. Nuk mund të jemi prezent në një farsë të sajaur. E dini si është kjo atmosfera? Si ata që lindin vajzë e pastaj thërrasin dasmën, e në fund e kanë fajin dasmorët pse lini vajzë. Kjo mblledhje është një farsë. Kryeministri e ka thënë fjalën e tij se është kundër. Përfaqësimi këtu është i ulët, asnjë rektor nuk ka ardhur. Ne duam që ta nisim vetingun në politikë nga vetja", u shpreh deputeti i PD-së. Por kreu i Kuvendit Z.Boçi ruçi u përgjigj gromoz bëhet fjalë për ndryshime kushtetuese dhe kjo kërkon kohën e saj. "Kjo nuk ka fare zvarritje, por nuk duhet të ketë as ngutje, sepse bëjmë ndryshime kushtetuese", deklaroi kreu i Kuvendit. Akademikët dhe pedagogët e juridikut kundërshtojnë ndryshimin sërish të Kushtetutës me qëllim kryerjen e vetingut në politikë. Këshilli i Legjislacionit dhe Komisioni i Ligjeve zhvilluan dje mblledhjen e radhës për shqyrtimin e nismës së Partisë Demokratike për ndryshime kushtetuese me qëllim kryerjen e vetingut në politikë. I ftuar nga Kuvendi, Arben Malaj si përfaqësues i akademikëve, tha se nuk është serioze që Kushtetuta e një vendi të ndryshohet çdo vit". Kushtetuta e vendit tonë nga një libër themelor për vlerat dhe parimet funksionale po bëhet më shumë një libër rregullash"-u shpreh z.Malaj. I të njëjtit mendim ishte dhe pedagogu i Fakultetit Juridik, Artan Hoxha, i cili hyri në



Komisionin legjislativ

detaje të propozimit, duke shprehur dyshime për organin që do të bëjë vetingun e politikanëve. "Çfarë do të jetë ky organ, një superorgan dhe kush e garanton që

ky organ të mos përdoret politikisht. Nëse ka një mundësi që situata të zgjidhet me ligj atëherë nuk keni pse i drejtoheni Kushtetutës"-u shpreh z.Hoxha.

Ermir Dobjani pedagog juridiku i UT deklaroi: "Parazitja e këtij projektligji kushtetues në këtë formë, pa asnjë projekt paraprak për zbatimin e tij është pje-

AKADEMIKËT

Akademikët dhe pedagogët e juridikut kundërshtojnë ndryshimin sërish të Kushtetutës me qëllim kryerjen e vetingut në politikë. Këshilli i Legjislacionit dhe Komisioni i Ligjeve zhvilluan dje mblledhjen e radhës për shqyrtimin e nismës së Partisë Demokratike për ndryshime kushtetuese me qëllim kryerjen e vetingut në politikë.

DENONCIMI

Ish-kryeministri Berisha publikoi dje një mesazh të qytetarit dixhital ku ky i fundit bën një denoncim. Në mesazhin e tij qytetari i shkruan Berishës se Drejtoria e Sigurimeve Shëndetësore do të privatizohet shumë shpejt. Berisha e cilëson këtë dëshmi, një tjetër akt të vjedhjes së pasurisë publike.

sa më e dobët e këtij projekti". Mbledhjet konsultuese do të vijojnë, ndërsa vendimarrje nuk do të ketë deri në ardhjen e rekomandimit nga Komisioni i Venecias.

Në takim nuk ishin përfaqësues të universiteteve të rretheve, por Kuvendi ka parashikuar që të shkojë në qytetet ku ato janë vendosur për të bërë konsultime.

Presidenti bën bashkë Berishën, Bashën dhe Ballën

Meta vlerëson ish-ministrin italian me titullin "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"

Mes tensioneve politike, Presidenti Ilir Meta bëri dje bashkë ish-kryeministrin Sali Berisha, kreun e PD-së Lulzim Basha dhe kreun e grupit parlamentar të PS, Taulant Balla. Politikanët shqiptarë morën pjesë në ceremoninë e vlerësimit të ish-ministrit italian, Franco Frattini me Dekoraten e lartë "Gjergj Kastrioti Skënderbeu". Mesa duket palët politike të PD-së dhe PS-së kanë vendosur të lënë mënjatë përplasjet politike për pak castë. Në ceremoninë ishin të pranishëm dhe figura të tjera politike si ish-ministria e Integritetit Klajda Gjoshja, apo depu-



teti i PD-së Tritan Shehu. Ish-ministri i Jashtëm i Italisë ka shprehur bindjen se në qershor të vitit të ardhshëm Shqipëria do të hapë negociatat me Bashkimin Europian. Në ceremoninë e mbajtur në Presidencë, ku Frattini u vlerësua nga Meta me dekoratën "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", ish-zyrtari ital-

ian tha se rruga e vetme e vendit është krah Evropës. "Shqipëria ka vetëm një rrugë për t'u bërë anëtare e Bashkimit Europian. Dhe unë jam i sigurt, shpresoj dhe mendoj se që nga muaji qershor i vitit 2019 ju do të filloni negociatat për anëtarësimin në BE. Dhe unë jam i sigurt që do e shikoj me sytë e mi kur të kthehem në Tiranë në progresin e madh të bërë nga Shqipëria", deklaroi z.Frattini. Ndërkohë presidenti Meta vlerësoi kontributin e Frattinit në përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe që kulmuan në partneritetin strategjik në shkurt të vitit 2010.



Qeveria nxjerr ish-të përndjekurit nga zyrat, PD: Rama, buratin i diktatorit

Partia Demokratike dënoi dje vendimin e qeverisë për largimin e Shoqatës Antikomuniste të Ish-të Përndjekurve Politike nga selia ku ndodheshin prej vitesh. PD deklaroi se Edi Rama po sjell para syve të shqiptarëve hijet e të kaluarës dhe po vepron si nostalgjik fanatik, që ka si objektiv vetëm rikthimin e regjimit autokratik. Sipas PD-së, akti i qeverisë është dëshmi se liritë dhe të drejtat e shqiptarëve po treten përditë dhe se vendi po shkon me shpejtësi drejt një përplasjeje civile si në vitin 1991. Po kështu PD thekson se kjo është dëshmia e radhës se shqiptarëve po u treten përditë liritë dhe të drejtat e tyre dhe se vendi po shkon me shpejtësi drejt një përplasjeje civile si më 1991-ën, prej të cilës qeveria e Edi Ramës do të ketë të njëjtin fund si regjimi i atit të tij ideologjik. "Veprimi i qeverisë së Edi Ramës është provokim më i ndyrë social dhe sulmi i radhës ndaj demokracisë në Shqipëri. Është dëshmia e radhës se shqiptarëve po u treten përditë liritë dhe të drejtat e tyre dhe se vendi po shkon me shpejtësi drejt një përplasjeje civile si më 1991-n, prej të cilës qeveria e Edi Ramës do të ketë të njëjtin fund si regjimi i atit të tij ideologjik"-thuhet në deklaratën e PD.

SHPLLJE ANKANDI
Datë 24.10.2018, Ora 16:30

Shoqëria Përbarimorë "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të dorëzuarit Bajfar Alush Murto: "Trulli + Ndërtesë" me sipërfaqe trulli 300 m2 dhe ndërtesë 81 m2, regjistruar në regjistrin hipotekor me vullm nr. 3, faqe 76, zona kadastrale 3316, nr. pasurisë 987, adresa: Shalës, Sarandë.

Cmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 1 008 000 (një milion e tetë mijë) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

SHPLLJE ANKANDI
Datë 23.10.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përbarimorë "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Shpall ankandin e tretë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Agron Shefqet Burhani dhe dorëzueses Halilhe Shefqet Burhani: "Apartament + Trulli" me sipërfaqe 62 m2, nr. pasurie 14/301, zona kadastrale 3574, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 2361 datë 07.10.1994, me adresë: Laga "15 Shator", pallati 53, shkalla 1, apartamenti 4, Topelëni.

Cmimi fillestar i ankandit të tretë është në shumën 806 400 (tetëqind e gjashtë mijë e katërqind) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Dosja e prokurorisë që la në qeli këngëtarin: I kërkoi shokut të fshinin gjurmët e gishtave nga arma

"E gjujta at' senin", përgjimet e Stresit

Reperi: Sa t'kesh munci nimon me naj gjo t'vogël, ti e di kërkimi do lekë

Arkimed Lushajt do t'i duhet të përballet me drejtësinë nga brenda qelisë, lidhur me akuzat për armë dhe drogë. Reperi i njohur, Stresi, nuk ka mundur të lërë burgun brenda 48 orëve, pasi gjykata ka vendosur të pranohet të ligjshëm arrestimin e policisë, nisur nga provat e paraqitura nga organi i akuzës. Në dosjen në ngarkim të 31-vjeçarit Lushaj, prokuroria ka zbardhur përgjimet telefonike të tij, përgjime që datojnë në periudhën 26 qershor 2018 deri më 11 korrik 2018. Në bisedë reperi flet me një shok të tij, ku e informon për pistoletën e gjetur nga policia pranë shkollës "Partizani". Në një prej bisedave që daton më 3 korrik të këtij viti, rreth orës 13:32 minuta, ai merr në telefon një prej miqve të tij, ku prezantohet me generalitetet e tij. "Zoti ju lasht shnosh e ju past lan me jet ju tjerëve. Me respekt Arkimed Lushaj", thuhet në dosjen e prokurorisë. Pasditën e po të njëjtës datë, ai komunikon me të njëjtin person, ndërsa nga biseda rezulton se komunikojnë për momentin kohor të ngjarjes, aksionin e policisë pranë shkollës "Partizani", ku u gjet një armë e braktisur. Stresi, (në përgjimet e bisedës më poshtë me numrin 723) njofton mikun e tij në lidhje me kontrollin e policisë dhe faktin se ka qenë ai që ka pasur armën dhe kur ka parë efektivet e ka hedhur, ndërsa i thotë të marrë në telefon të atin, Sali Lushajn, për të mesuar mbi vijimësinë e operacionit.

723: Po, edhe e hudha unë atë e kupton po e kanë kap, po s'kanë pa mu që e kam hudh.

Ç'THOTE AVOKATI

Avokati i Stresit, Marash Ibraj ka deklaruar në seancë se arrestimi është i paligjshëm, pasi klienti i tij është ndaluar në një dhomë hoteli dhe ka dënuar ashpër publikimin e pamjeve nudo nga ana e Policisë së Shtetit.



909: Po pse o vlla?
723: S'e di erdhën aksion, ika me gjysëm zemre kam lëviz.

909: Ka je ti?
723: Jam këndeje ke një shok, hajde. Po fol pak me Salën, bjeri pak dhe fol pak me të.

909: Ça ti them?
723: Po merre njëherë pyete ca bëhet, ç'a situatë është? Merre njëherë të lutem.

Më tej i njëjti person e merr në telefon Arkimed Lushajn dhe e njofton se babai i tij, Sali Lushaj i kishte ndjekur të gjitha veprimet e policisë.

723: Hë, mirë?
940: Po kanë ik mor byt***mat, ka shkove?

723: Po a e morën atë?
940: Jo mor burrë, i ndjeku Sala. A keni nai hall me na njoh.

723: Jo pa e kapën atë senin se e kam gjujt atë senin mor.

940: Jo mor burrë, asnjë

gjë në botë, i ndoqi Sala, ikën.

Në vijim të bisedës, shoku i tij i kërkoi 31-vjeçarit t'i tregojë vendin se ku e kishte hedhur armën, por ky i fundit i thotë se atë e kanë marrë tashmë forcat e policisë. Më vonë Stresi komunikon sërish me mikun e tij, i cili i thotë se nëpërmjet të atit të arrinin të fshinin gjurmët e gishtave që mund të kishte lënë reperi në armë.

940: He byrazer.
723: O byrazer pyete Lir Selmanin se atij ia kam marrë makinën kam dy ditë, a e ka me qira këtë apo?

940: Makinë me qira e ke këtë? - jo thotë. Është e Gentit që punon në Rinas.

723: A mirë, thuj se sot më duhet mua, se ashtu e kam hallin, se më duhet të lëviz njëherë. Se ja bie vetë e gjej unë robin, kështu thuj.

940: Mirë mo më tha se isha tu i ni krejt unë, ka iku tha.

723: Për mua e?

940: Po sa e kam pa, ik i thash. Tha i kam bëmë dorë.

723: Si, Si?

940: Ai shefi tha i kam thënë tha, se e mori Sala atë shefin, ia kam bëmë dorë të parit. atij i thash ik.

723: Si, Si?

940: Te parit ty ta ka bëmë me dore, a ta boni me dorë ik?

723: Po.

940: Po pra, se e mori Sala atë shefin e komisarariatit.

723: E ç'a u bo tash?

940: Ku di gjë, kena pas informacion tha.

723: Për armën e?

940: Është një motër*** që i ka marrë në telefon. Duam një që iku - më tha - atë kërkojmë.

723: E Fisniku.

940: S'di gjë, ka ik i thash.

723: Po e kanë marrë me vete e?

940: Po, atë e kanë fut mrena.

723: Cilin atë, të madhin e?
940: Po.
723: Ai pa lidhje krejt o vlla.

940: Të shkoj ta kapi unë o shok së e kapa kot, t'i them unë Salës me stil.

723: Ç'a?

940: T'i thojë atij ta fshije.

723: Po ai ç'a ka me, i thënë tash se atë e kanë marrë e kanë thirr. E kanë marrë vesh tan ata policë.

940: I tha çastu, çastu po e kena në makinë tha, e kena gjet aty.

723: Arme e?

940: Po. Po problem është se është tek për tek me të e kam mundësi me ja tënën një fjalë.

723: Ishalla o Zot, hajde.

940: Po me i thënë unë çastu, çastu thuj ta pastrojë.

Me vonë miqtë komunikojnë sërish në telefon, ku


shoku i thotë Arkimed Lushajt se fshirja e armës ishte e pamundur. fshirja e gjurmëve të gishtave në armë.

Në vijim të përgjimeve, në datën 4 korrik 2018, Stresi i dërgon mesazh një shoku të tij në telefon ku e informon në lidhje me faktin se është në kërkim. "O vllaj jam në kërkim. Jam jashtë Tirone. E sa t'kesh munci nimon me naj gjo t'vogël se ti e di, kërkimi do lekë". Në bazë të këtyre përgjimeve, prokuroria kërkoi që ndaj 31-vjeçarit Arkimed Lushaj të caktohet një nga masat e sigurimit personal nën akuzën e "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armeve shpërthyes e municionit".

PISTOLETA-PËRGJIMI

Stresi i kërkoi ndihmë Bajrit: Dua të dal jashtë Shqipërisë

Ndonëse mendohej se Stresi i kishte mbyllur telashet me drejtësinë shqiptare, me sa duket nuk ka qenë kështu. Kjo për shkak të një arme të gjetur pak javë më parë tek shkolla "Partizani". Policia ngriti dyshime të forta se arma i përkiste reperit dhe për këtë arsye kishte kërkuar arrestimin e tij. Përkishtë për këtë vendim, Stresi kishte kërkuar ndihmë nga Bajrat për t'u larguar jashtë vendit. "Më ndihmoni të iki jashtë se policia po me përgjon, se sa pashë që po më afroheshin, unë e hodha armën", ka thënë në telefonatën e bërë me një nga anëtarët e bandës Bajraj, Stresi, bisedë e përgjatur nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Ndërkohë, një tjetër armë iu gjet në momentin e arrestimit në dhomën e hotelit ku ishte me një vajzë.



BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ





Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

GLOBAL PROGRAMME MIGRATION FOR DEVELOPMENT

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The Global Programme „Programme Migration for Development“ is commissioned by the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) and is being implemented under the umbrella of the Centre for Migration and Development (CIM) – a joint operation of the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) and the International Placement Services (ZAV) of the Federal Employment Agency.

The overarching objective of the programme is to strengthen the development-relevant contributions of migrants in their countries of origin and improve the framework conditions for regular migration in selected partner countries.

One of the programme's component is "Migration and Reintegration Advice" under which the PME is operating an Information Centre for Migration, Vocational Education and Career Advice (Deutsches Informationszentrum für Migration, Ausbildung und Karriere – DIMAK Albania). The centre's target group are potential migrants as well as returning migrants from Germany. DIMAK Albania offers counselling services on perspectives of educational and professional development in Albania, as well as information and advice on possibilities and requirements of legal labour migration. In order to optimize the services of DIMAK for the target group, the project is intending to hire staff designated to advice potential migrants and especially returning migrants and to provide them with necessary information on migration as well as on social and professional reintegration. Next to the Centre itself, the PME is establishing an information and advice structure in Germany for migrants intending to return to their home country (Germany module). The advisor will cooperate closely with counterparts within the Germany module and within the bilateral portfolio of GIZ's country office.

GIZ Office Albania seeks the following staff: Advisor - Migration and Reintegration

A. Responsibilities:

The position holder will carry out advice giving services in the above mentioned frame to individuals seeking counselling and support, especially to migrants who have returned from Germany to Albania. He/She works in a team of advisors under the supervision of the Centre's National Coordinator. He/She exchanges with his/her counterparts in the Germany module in order to provide country-specific information to migrants intending to return from Germany. He/She works in a team and is in charge for reporting and monitoring of the project and provides related content. He/She cooperates with relevant counterparts within bilateral projects of GIZ and GIZ country office. He/She supports the National Coordinator in all activities of the Centre's project, in everyday occurrences and will fulfil tasks that will be delegated by the National Coordinator, Country Director and the Programme Coordinator of PME, based in Eschborn, Germany.

B. Tasks

The Advisor performs the following tasks:

Advice and Monitoring

- Provide project related information, counselling and advise to the visitors of the DIMAK (as-sistance, advice and guidance), face to face and virtual
- Implementing a client monitoring and tracking, following up on counselling talks
- Conducts research, review, prepares and forwards relevant reports and documents and helps update the office and project/programme website.
- Works on impact monitoring, quality management, communication and documentation of the proper implementation of project plans and activities in close consultation with partner institutions.
- Supports with the necessary coordination processes to produce publications and materials in accordance with GIZ standards (corporate design, standards for content)
- Works in a team for reporting and monitoring of the project and provides related content.
- Supports with planning and execution of capacity-building activities, providing on-site support as needed
- Cooperates with relevant counterparts within bilateral projects of GIZ and GIZ country of-fice.
- Participates in outreach activities, mobile advice, giving presentations to the target group

Crosscutting Tasks

- Assists the short-term experts assigned to project in completing their tasks including translation
- Preparation of appropriate input for project outputs as required by the project management and GIZ head office.
- Does backstopping to the project coordinator on the ongoing developments on the topic of migration advice in Albania and the activities of the government regarding this topic
- Provides general administrative support
- Updates the relevant folders of the GIZ Knowledge to facilitate access to key information for tenders such as project references, performance confirmations from clients etc.
- Carries out secretarial support and manages the filing system, follows up information flow and deadlines, prepares notification letters, archiving, agendas for meetings
- Prepare various written outputs, such as background papers, correspondence with governments, working papers, mission reports, presentations and ad hoc reports and participates in relevant meetings and conferences in the area of migration in Albania
- Takes on additional and ad-hoc tasks related to the profile describes assigned by the coordinator of PME in Albania
- Maintains the networking and cooperation with partner institutions and other relevant stakeholders (including non-governmental agencies, research institutes, business and other projects and donors), by ensuring good working relationships and sustainable cooperation towards the project's objectives.
- Ensures good communication and flow of information within GIZ and with other relevant actors
- Ensures good flow of information and coordination is established with all local and international partners

Required qualifications, competences and experience:

- Holds a university degree and has at least 4 years of relevant experience, particularly within international organisations
- He/she has relevant work experience in fields such as migration / advice of vulnerable groups / labor market / vocational training or another field that qualifies him/her for the occupation and has excellent communication and presentation skills
- Work experience with a public employer in the country of deployment would be an advantage
- Ability to support a multi-task, multi-discipline programme team
- Excellent working knowledge of MS products, particularly Word, Excel and PowerPoint
- Fluency in written and spoken English and Albanian. German language would be a strong asset
- Able to work in a team as well as independently
- Excellent social and communications skills

Contract conditions

- Full-time employment
- Project office in Tirana
- Duration: 2 years

Please forward your application until **28th of October 2018**, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de , including the following information: Application letter, CV in English (Euro Pass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. They might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Regional Program "Conservation and Sustainable Use of Biodiversity at Lakes Prespa, Ohrid and Shkodra/Skadar (CSBL)"

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The regional program "Conservation and Sustainable Use of Biodiversity at Lakes Prespa, Ohrid and Shkodra/Skadar" (CSBL) assists Albania, Macedonia and Montenegro since 2014 in managing the natural resources of Lakes Prespa, Ohrid and Shkodra on a transboundary basis and in compliance with EU environmental and biodiversity protection targets – with particular focus on relevant European Union Directives, including the Water Framework Directive (WFD) and the Habitat and Birds Directives. The program also addresses issues related to sustainable fisheries. With strong cooperation among stakeholders within and among countries being crucial to achieving the program's objectives, a major focus is on water diplomacy and the institutionalization of transboundary cooperation.

The current project phase is January 2018 until June 2020.

GIZ Office Albania seeks the following staff: Coordinator

A. Responsibilities

The Coordinator is responsible for:

- Representing the CSBL program as national coordinator in Albania (with its three Lakes Prespa, Ohrid and Shkodra/Skadar), coordinate activities, services and events for all project thematic areas in Albania (Water Resources Management/Water Framework Directive, Bio-diversity Conservation, Sustainable Fisheries and Transboundary Cooperation)
- Advising national partners and relevant stakeholders on the implementation of the thematic areas Water Framework Directive, Biodiversity Conservation, Sustainable Fisheries and Transboundary Cooperation in Albania
- Drafting (sub-)programs, log-frames and ToR for national, regional and international experts
- Coordinating expert missions in Albania and follow-up on activities/results
- Cooperating with multiple stakeholders at local, national and regional levels, including Trans-boundary Water Commission, Lake/Fisheries Commissions, Ministries, Municipalities, Protected Area Administrations, Professional Associations, the Fisheries Management Organization of Albania as well as Non-governmental and Research Organizations
- Closely collaborating with CSBL national coordinators in Montenegro and Macedonia, re-spectively, and conduct joint activities
- Closely collaborating with the project's advisor on transboundary cooperation

In this context, the Coordinator fulfils the following tasks:

B. Tasks

Advising partner institution(s)

The coordinator

- assists and monitors the development and implementation of project/programme plans and activities in close consultation with counterparts,
- contributes to preparing and implementing the coordination process, joint project/pro-gramme activities and work at the regional level,
- supports and initiates the design, preparation and implementation of workshops, seminars and other events on issues connected with the project/programme's area of activity,
- develops and organises quality assurance measures and suggests necessary changes, im-provements and initiatives.

Networking and cooperation

- supports and initiates cooperation, regular contact and dialogue with relevant project gov-ernment partner and non-governmental partners on all levels including cooperation with lo-cal communities, relevant organisations, non-governmental agencies and individuals in the project/programme environment and with other projects to improve and maintain good working relationships,
- assists with PR and communication work,
- communicates local interests and efforts, towards these and encourages sharing ideas and information for the benefit of the project/program.

Knowledge Management

- ensures knowledge transfer to project/programme information,
- develops ready-to-use strategies and technical concepts, including guidelines, manuals and procedures,
- draws up reports and presentation documents,
- prepares appropriate input for various project/programme reports including annual reports, and contributes to the other reports required by the programme manager and GIZ Head Of-fice,
- assists with research activities and studies on political issues which benefit joint pro-grammes.

Coordination tasks

- assists with general project planning and develops project concepts including preparation, organisation and moderation of planning exercises and their implementation, management, monitoring, quality management, evaluation, communication and documentation,
- coordinates relevant project activities at local level in consultation with the manager and in cooperation with the partners, both as regards to implementation and preparing organisational aspects,
- compiles the relevant information for joint activities and assignments,
- contributes to offer management on behalf of GIZ (e.g. offer preparation, impact monitoring, project progress review, reporting).

C. Required qualifications, competences and experience

- Advanced university degree in environmental sciences, natural/water resources management/hydrology, environmental law, environmental economics or related disciplines
- At least 7 years working experience in the field, of which 5 years in international settings
- Profound knowledge of water resources management in Albania and internationally
- Familiarity with relevant national environmental policies, strategies and legislation, in particular with respect to EU-compliant water resources management, biodiversity conservation and nature protection legislation, as well as inland fisheries
- High level of professionalism and cultural/political sensitivity
- Strongly developed diplomatic skills
- Strong analytical, planning and managerial skills
- Distinguished sense of responsibility and proactiveness
- High communicational, integrative and organizational skills – as well as interface competence
- Excellent spoken and written English and Albanian language skills
- Knowledge of German, Macedonian and/or Montenegrin would be an asset

D. Contract conditions

- Full-time employment
- CSBL project office in Tirana with duty travel within Albania and the region (Mainly Macedonia and Montenegro)
- Assignment period until June 2020

Please forward your application until **28th of October 2018**, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de , including the following information: Application letter, CV in English (Euro Pass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. They will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

KOLEGJI UNIVERSITAR "LUARASI" LEKSION I HAPUR

Aelita Mani: Praktika jonë, të sjellim modele suksesi për studentët tanë

Voltiza Duro

Studentët e Fakultetit Ekonomik në Universitetin "Luarasi" kanë pasur mundësinë të jenë pjesë e një leksioni të hapur të mbajtur nga një ekspert i shquar amerikan. Gjatë kësaj ore, Scott Sorrell, profesor në California State University u ka shpjeguar konkretisht studentëve sesi të ndërthurin praktikën me teorinë për të qenë konsulentë të suksesshëm biznesi në të ardhmen. Studentët e Ekonomikut në "Luarasi" kanë mësuar gjithashtu sesi të bëjnë një punë sa më të vlefshme, të arrijnë t'i japin klientit çmimin më të lartë dhe në fund ai të ngelet sërisht klienti i tyre besnik. Scott Sorrell është një nga konsulentët më të mirë në shumë kompani biznesi, me përvojë dhe praktika akademike të shkëlqyera. Ai shprehet tejte i kënaqur që ishte pjesë e leksionit të hapur në Universitetin "Luarasi", të cilin e vlerëson si një institucion madhështor. "Unë jam Scott Sorrell dhe në botën e biznesit më quajnë 'Zotëria që ngarkon çmimet më të larta', sepse unë iu bëj konsulentë kompanive sesi të vendosin çmime të larta dhe në fund klientët të ngelen të kënaqur dhe të thonë faleminderit. Gjithashtu, unë jam profesor në Californian State University, në të cilin ka 40 mijë studentë dhe jap mësim në Marketing", - thotë Sorrell. Ai shton se u emocionua shumë kur erdhi kërkesa për të dhënë një leksion të hapur në Universitetin "Luarasi", pasi dëshiroj të ndaj dijet e mia, njohuritë dhe dashurinë time me studentët. Unë i dua studentët dhe dëshiroj të kem impakt në jetën e tyre për të bërë ndryshime të mëdha dhe jo vetëm në fushën e biznesit, por edhe në zemrat e tyre. Kur dëgjoja që këtu ka shumë studentë që kanë nevojë të degjojnë një mesazh të mirë rreth marketingut, biznesit dhe jetës, isha i emocionuar dhe i gatshëm për ta bërë këtë. Dua të theksoj se u impresionova nga ky universitet, nga godina, nga pastërtia dhe më bëri përshtypje, pasi është indritshëm dhe i mbajtur në kushte shumë të mira. Është një universitet madhështor, me stu-

Universiteti "Luarasi", leksion i hapur me ekspertin amerikan

Scott Sorrell: Institucion madhështor i arsimit të lartë



të huaj janë praktikë e eksperimentuar edhe më parë në këtë universitet elitare. "Këtë praktikë e kemi eksperimentuar edhe më parë duke sjellë biznesin pranë studentëve tanë dhe madje, edhe studentët i kemi cuar te biznesi për të bërë detyra dhe projekte konkrete, për të mësuar që në fillim, për të përputhur njohuritë me praktikën, por kjo është një formë e mësimdhënies ku studentët përgatiten për të qenë konsulentë biznesi. Është fat i madh për studentët e Luarasit, që profesorë të tillë na nderojnë dhe pranojnë të japin të gjithë përvojën e tyre akademike dhe praktike nga biznesi dhe akademika. Është praktikë e Universitetit 'Luarasi' që profesorë të tillë t'i kemi gjatë gjithë vitit për të organizuar leksione të hapura. Siç e shikoni, vetëm në javën e parë u mundësojmë studentëve tanë praktikën të tillë", - shton shefja e Departamentit të Administrimit-Biznesit të "Luarasi". Një praktikë praktikave të tillë, "Luarasi" vazhdon të mbetet një ndër liderët e arsimit të lartë në vend, duke sjellë përvojën më të mirë ndërkombëtare pranë studentëve, e duke prezantuar modele suksesi që i japin më shumë guksin e orientim për të ardhmen.



UNIVERSITETI MADHËSHTOR
"Është një universitet madhështor me studentët të mrekullueshëm, që na priten me buzëqeshje. Edhe stafi pedagogjik më mirëpritur dhe nuk kisha ndjesinë sikur isha në një shkollë, por u ndjeva më shumë pjesë e një familjeje", - thekson konsulent i fushës e biznesit.



PRAKTIKAT ME EKSPERTË
"Është praktikë e Universitetit 'Luarasi' që profesorë të tillë t'i kemi gjatë gjithë vitit për të organizuar leksione të hapura. Siç e shikoni, vetëm në javën e parë u mundësojmë studentëve tanë praktikën të tillë", - shton Aelita Mani.

dentë të mrekullueshëm, që na priten me buzëqeshje. Edhe stafi pedagogjik më mirëpritur dhe nuk kisha ndjesinë sikur isha në një shkollë, por u ndjeva më shumë pjesë e një familjeje", - thekson konsulent i fushës e biznesit.

LEKSIONET E HAPURA TË "LUARASI"
Shefja e Departamentit të Administrimit-Biznesit në "Luarasi", dr.shk. Aelita Mani tregon se kombinimi i teorisë me praktikën është mënyra më e mirë për të përgatitur konsulentë ekspertë në fushën e biznesit. "Në Universitetin 'Luarasi' zhvillohet orë e hapur

leksionit me profesorin e shquar të marketingut, Scott Sorrell, i cili ka ardhur nga California University në Kanada. Kjo është një orë konkrete e hapur, ku studentët tanë do të prekin përvojat e mësimdhënies moderne dhe në stilin praktik të tyre. Në këtë mënyrë, studentët do të ndihmohen me njohuritë që ata kanë dhe në të njëjtën kohë profesori është lektor dhe konsulent i shumë kompanive, ka përvojë dhe praktika akademike dhe biznesi, të cilat i ndërthur për punën dhe mësimdhënien e studentëve të vet", - thotë Mani. Më tej, ajo tregon se leksionet e hapura me ekspertë

NJOFTIM

Shoqëria "GPP Korça" sh.p.k., propozon ndërtimin dhe operimin e një termocentrali me gaz me cikël të kombinuar kogjenerimi CCCPP KORÇA 500 MW/ 80 MW/ 6 MW në zonën pranë qytetit të Korçës, saktësisht përballë Impiantit të Trajimit të Ujërave të Qytetit të Korçës. GPP Korça ka kontraktuar kompaninë ABKONS sh.p.k. për realizimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si shoqëri e lincensuar për veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis.

Për këtë qëllim, Ju njoftojmë se në Korçë do të mbahet një Dëgjës Publike për të bërë publike rezultatet e vlerësimit mjedisor dhe për të diskutuar dhe mbledhur komentet dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit.

Dëgjësja Publike do të mbahet në datën **26 Tetor 2018** në orën **12:00** në sallën e takimeve tek **"Grand Hotel Korça"**



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e suportit vjetor të produktit Fire - Eye"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,800,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10:00 – 13:00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë parapakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përsëkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e suportit vjetor të produktit 'Fire - Eye'"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **12 Nentor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

EKSPOZITA

Shqiptaro-rusi Sergeji Sherko dhe shqiptarët duarartë që studiuuan në Itali

Fatmira Nikolli

Ishte një ditë tipike vjeshte pie monteze e 1996-ës, kur Artan Shabani prezantonte në Torino një ekspozitë në rrugën që mban emrin e lumit Po. I kujtohet ende lagështia e ajrit që hynte nga portikatet e larta në sallën e ekspozitës, ajër piemonti që shpesh e ndjente në pikturat e Felice Casorati apo të Gigi Chessa-s.

Vizitorët ndaleshin përballë portreteve tipike të malësoreve ose të burrave me fustanella të jugut shqiptar, kur pranë piktorit të ri, afrohet një zotëri i moshuar, i shoqëruar nga një djalë i ri. I afrohen dhe e pyesin nga është. Shabani iu thotë se është shqiptar. Ata i flasin shqip gjatë gjithë ceremonisë dhe pas saj, ulen në Piazza "Cavour".

"Ai njihej si z. Sherko dhe ishte një burrë fisnik, me shumë kulturë, që kishte studiuar në Torino gjatë viteve '30-'40. Më foli për vitet e një Italie të panjohur për mua, më foli veçanërisht për studentët shqiptarë që në ato vite kishin frekuentuar shkollat italiane, nga jugu në veri, nga Trieste në Torino, nga Milano në Napoli e kështu me radhë, por kënaqësinë më të madhe e kishte kur fliste për piktorët dhe skulptorët e diplomuar në akademitë italiane. Shpjegonte me zellin e një kuratori të përkyer, fort të dashuruar pas artit dhe kulturës", thotë Shabani.

Sergej Sherko rrëfente se kishte lindur në Odessa më 1920 nga një baba shqiptar (Mihal Sherko) dhe një nënë ruse (Elena D'Arkudinski). Ajo ishte vajza e kryebashkiakut të Odessës dhe familja e saj bënte pjesë në aristokracinë ruse me lidhje gjaku me Romanovët. Më 1924 ikin nga Rusia e vijnë në Shqipëri. "Sherko e kishte filluar shkollën fillore italiane më 1926 në Tiranë dhe më 1931, kur ishte 11 vjeç kishte shkuar në Korfuz për të vazhduar shkollën tetëvjeçare. Zotëronte në mënyrë ekselente rusishten, shqipen, italishten dhe frëngjishten, në Korfuz perfeksionoi dhe greqishten e latinishten. Më 1936 në moshën 16-vjeçare shkon në Torino ku studioi në kolegjin e San Giuseppe, që frekuentohet edhe sot nga elita e Torinos. Në kursin e një viti më poshtë ishte Buongiorno dhe Giovanni Agnelli. Mbas mbarimit të liceut më '41 vazhdoi fakultetin ekonomik, shkollë që mund ta bënte me korrespondencë meqë ishte kohë lufte. Donte shumë mjekësinë ndaj e frekuentonte sa herë mundej. Me fillimin e bombardimeve më 1943 në Torino u kthye në Shqipëri ku do të mbetet për 50 vite në izolim", thotë Shabani, duke zbuluar kështu një personazh të rrallë që në Tiranën e zymtë komuniste bashkonte epo-



Pinjollit i aristokracisë, Artan Shabani: Një bisedë në Torino më 1996



ka e elita. Kur Sherko do të kthehej në Torino pas 5 dekadash, shokët 24-vjeçarë i rigjeti 70-vjeçarë. Mes miqve të tij kishte qenë dhe Nako Spiro, që e kish njohur në Korfuz dhe kishte ndarë me të shtëpinë në Corso Vinzaglio. Në Itali e thërrisnin Sergio, në Shqipëri nga Sergej i thirrën Sergj. "Ishte brezi i fundit që kishte studiuar në akademitë italiane dhe në Europën Perëndimore. Për të gjithë të tjerët do të mbetet një ëndërr e ndaluar deri pas rënies së Murit të Berlinit"-thotë Shabani. Ende sot, kujton se në fjalët e Sherkos ndihej entuziazmi i periudhës kur Italia spikaste me avan-

gardën, me krijimin e grupeve artistike, me efektet e rrymës futuriste, një lëvizje intelektuale që depërtoi në porët e shoqërisë italiane falë gjenisë së artistëve si Severini, de Chirico, Martini, Sassu, Fontana, Carena, Tamburi, Levi, që thyen ekuilibrin e pikturës akademike duke lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë artistike të Nëntëqindës. Është periudha kur komponentët kulturorë të "Belpaese" njohin një pasurim të madh. Shumë artistë, intelektualë nga USA apo vende të ndryshme të Europës frekuentonin qytete si Roma, Venecia, Firenze, Napoli, etj. duke e kthyer Italinë në një

destinacion të rëndësishëm për të kryer studimet në fusha të ndryshme, dhe veçanërisht për artet e bukura. Janë pikërisht vitet në të cilat studentët shqiptarë shkojnë në Itali dhe veçanërisht në Romë për të frekuentuar shkollat dhe akademitë e arteve italiane. Artistë si Buza, Reçi, Koljaka, Billosmi, Tuçi, Idromeno, Kolombi, Stamo, Paskali, Mio përjetuan një moment të rëndësishëm të kulturës italiane që kushtëzoi formimin dhe krijimtarinë e tyre të hershme dhe që përfaqësoi më pas bagazhin kulturor që i kaloi gjeneratave që edukuan në Akademinë e Tiranës.

Burri i mençur Sherko, me sy të përplotur, më rrëfue rikthimin e tij në Tiranë. Ishte pra, edhe ai një nga ata shqiptarët e ikur dhe të kthyer. I pat treguar bisedat me Jusuf Vrionin dhe me shokët e kohës studentore.

KOLEKSIONI

Qenë të këtyre kohëve edhe brezi i piktorëve që Shabani ekspozoi tani në rezidencën italiane në Tiranë. Ekspozita "Vizion kufijsh" me 42 tablo, të artistëve shqiptarë, që kanë studiuar në akademitë italiane në gjysmën e parë të shekullit të XX. Gjatë viteve '30-40 artistët që ekspozohen së bashku kanë studiuar në akademitë italiane, e një pjesë e tyre krijuan shkollën e vizatimit dhe liceun e arteve. Koleksioni që prezantohet në Rezidencën italiane është pjesë e vyer e trashëgimisë artistike të atij brezi, që familjaret e artistëve kanë konservuar me dashuri të pamasë dhe me kujdes të veçantë. Çdo vepër e këtij katalogu, mbart intimitetin e një jete të tërë, që në e trajtojmë me respektin që u takon artistëve dhe kujtesës së tyre. Drejtori i projektit dhe kuratori i kësaj ekspozite, të titulluar "Vizion Kufijsh", Artan Shabani ka bashkuar vepra të piktorëve Fadil Pullumbi, Guri Madhi, Ibrahim Kodra, Foto Stamo, Hasan Reçi, Simon Rrota, Nexhmedin Zajmi, Vangjush Mio, Zef Kolombi, Lin Delija, Vangjush Tushe.

"Kjo ekspozitë së pari, është një nderim për talentin artistik dhe forcën morale të njerëzve të cilët, të izoluar në Shqipërinë e Enver Hoxhës, u detyruan të bënin një zgjedhje ekstreme midis heqjes së lirisë së shprehjes dhe mërgimit. Ashtu siç shkruan në katalog Ylli Drihti, vetëm një pjesë e vogël zgjodhi arratisjen për të zhvilluar karrierën artistike dhe jetën në Itali. Shumica qëndroi, luftoi me sukses për të qenë në gjendje të ngushtë veten pavarësisht kufizimeve ideologjike të imponuara nga regjimi. Të dyja palët bënë një zgjedhje të guximshme", tha ambasadori italian në vendin tonë, Alberto Cuttillo. Ai shtoi se ekspozita është pjesë e një projekti më të gjerë që ambasada italiane në Tiranë po kryen për rindërtimin e atyre lidhjeve midis Italisë dhe Shqipërisë që - gjatë



viteve të Luftës së Ftohtë - dukeshin të ngrira, por që në realitet ishin ftohur nga një imponim i jashtëm që megjithatë nuk arriti të thyente afërsinë shumë të ngushtë kulturore midis dy vendeve tona. Ideja që secila prej pikturave të ekspozuara në Rezidencë përmbledh përvojën dhe intimitetin e artistëve të formuar në Itali.

Ekspozita ka shfaqur vepra të panjohura të Ibrahim Kodrës, vepra të harruara të Abdulla Cangonjit, të Simon Rrotës, Zef Kolombit, Kristina Koljakës.

SPECIALE

Fatmira Nikolli

Bala tash është qorr. Por ani: të verbër shokët e pranojnë. Edhe ai nuk ndihet aq i vetmuar si dikur"

Një roman psikologjik, duke shqyrtuar temën e një kënge të vjetër popullore, për përjashtimin, vetminë dhe hakmarrjen në një stil të pastër dhe shumë gojor.

Para pak kohësh u zhvillua në Paris, në librarinë "Editions intervalles 2", veprimtaria e titulluar "Mbrëmje letrare shqiptare". Në praninë e shumë lexuesve, francezë dhe shqiptarë, u bë prezantimi i dy librave të përkthyer kohët e fundit në frëngjisht: i romanit "Legjenda e vetmisë" i autorit Ridvan Dibra (në frëngjisht me titullin "Le Petit Bala. La Légende de la solitude"), i përkthyer nga Evelyne Noygues dhe i botuar nga Shtëpia Botuese "Le Ver à Soie", Paris; si dhe i librit "Shqipëria: kështjella përballë vetes" i Sébastien Colson - njëllloj udhërrëfyesi, ku autori synon të japë çelësin për ta kuptuar Shqipërinë bashkëkohore. Moderatorë të mbrëmjes ishin gazetarët Dauphiné Libéré dhe Sébastien Colson.

Përmes pyetjeve, por edhe diskutimeve, të pranishmit treguan interes për romanin "Legjenda e vetmisë", duke vlerësuar përmbajtjen, gjuhën dhe stilin e veprës, si dhe cilësinë e përkthimit në frëngjisht. Romani "Legjenda e vetmisë", botim i Shtëpisë Botuese "ONUFRI", është shpallur si romani më i mirë i botuar në hapësirat mbarëshqiptare për vitin 2012, duke fituar çmimin "Rexhai Surroi".

Në shënimet e botuesit francez, për këtë roman thuhet mes të tjerash: "Duke e marrë temën nga një këngë e vjetër ballkanase, Ridvan Dibra na ofron një roman psikologjik mbi përjashtimin, vetminë dhe hakmarrjen me theksa herë - herë edipianë. Me një stil të kthjellët e të drejtë-përdrejt e kënd lexuesin në mendimet torturuese dhe në psikologjinë e të riut Balë, i cili, pas vdekjes së pashpjegueshme e mizore të babait të vet, duket se është plotësisht i izoluar nga një mjedis aspak miqësor. I bindur se bëhet fjalë për një vrasje dhe se e njëjti mjaft mirë identitetin e vrasësit të babait, Bala i Vogël nis e fantazon gjithë kohës për hakmarrjen..."

Kurse në një analizë kritike të veprës në frëngjisht, poeti e kritikë Radu Bata shkruan mes të tjerash se: "Pas vdekjes brutale të babait, i bindur se bëhet fjalë për një vrasje dhe se e njëjti identitetin e vrasësit, Bala i vogël ia kushton kohën e tij fantazive të hakmarrjes. Duke e marrë temën nga një këngë e vjetër ballkanase, Ridvan Dibra ofron një mozaik letrar, duke

Ridvan Dibra


Me "Legjendën e vetmisë" në Paris

Përkthyesja Evelyne Noygues në garë për çmimin e përkthimit në Francë me romanin shqiptar

firamosur një tregim mjaft drithërues... Përmes syve të Balës shohim sesi jeta nis dhe e humb domethënie, ndjekim me ankth ligësinë e mizorinë e njerëzve. I ndarë mes njerëzimit e pyllit, Bala tërhiqet pak e nga pak drejt këtij të fundit. Dhe aty në strofullën e pyllit ai rigjen veten, gjen shpirtat e tij që e pajtojnë disi me jetën... Bala është një fëmijë me ndjeshmëri ekstreme, një fëmijë që e gatuan fatin e tij me intenzitetin e një Zoti të ri të ter-

të ndodhë), nuk besoj se do të shkruaj më. Kuptohet, shtysë "frymëzimi" është edhe shumëçka tjetër që në një mënyrë a në një tjetër, lidhet me ato që thashë në fillim, domethënë me grindjet e mia të brendshme. Kjo ndodh edhe në ato vepra që lexuesit mund t'i duken krejt "larg meje", si për shembull te romani im i fundit, "Legjenda e vetmisë". Një konceptim i tillë i krijimit, bën që proza ime të jetë e varfër me personazhe; në romanet e mia ndesh

përkthyesja e disa veprave letrare botuar në Francë dhe Shqipëri si dhe studiuja në fushën e historisë dhe letërsisë, Evelyne NOYGUES, shkoi në Shqipëri për studimet e saj në fund të viteve 1980, para se të banonte atje 1991-1994 duke punuar në frëngjisht dhe shqip. Ajo kthehet atje



rregullisht për projekte asociative, letrare dhe artistike. Së fundmi, ministria Mirela Kumbaro bëri me dije se përkthyesja Evelyne Noygues është në garë për

çmimin e përkthimit në Francë me librin e Ridvan Dibrës mbështetur nga Ministria e Kulturës me Fondin e Përkthimit nga gjuha shqipe.



rit... Është shkrimi i Ridvan Dibrës, i bukur dhe interaktiv (duke sfiduar lexuesin), që "marton" poetikisht këto argumente: kapituj të shkurtë dhe fraza të thjeshta, idetë e sinkronizuara që vijnë si refrenet e një kënge, titujt dhe fundet e kapitujve që përmbledhin në pak fjalë çka ndodh; si në rrëfimet e dikurshme. Përkthimi i përcjell me sqimë këto vegori dhe i bën ato të natyrshme..."

Në një intervistë të dhënë, Dibra është shprehur se "Vazhdoj të kem aq shumë pikëpyetje brenda vetes, aq shumë dilema e pyetje pa përgjigje. Nëse ato do të resh-tin një ditë (çka s'ka logjikë

jo më shumë një apo dy-tri karaktere. Në një kuptim, jam rreket të bëj një prozë sa më vertikale: drejt thellësisë e mistereve të qenies. Sa ia kam arritur, e gjykojnë të tjerët". Duhet përmendur se ky roman, i përkthyer në frëngjisht, është përzgjedhur në listën e ngushtë të veprave që konkurrojnë për çmimin e përkthimit në Francë Le Grand Prix SGDL - 2018, fakt ky që dëshmon punën plot talent e përkushtim të përkthyeses Evelyne Noygues, e cila është autore e disa përkthimeve nga shqipja në frëngjisht në prozë, poezi e dramaturgi. E diplomuar i Inalco,

Fibank Albania

dhe punonjësit e saj në mbështetje të Qendrës Sociale Tiranë

Në Ditën Ndërkombëtare Kundër Varfërisë, Fibank Albania u angazhua në një aktivitet human në Qendrën Sociale Tiranë, e sapohapur nga Kryqi i Kuq Shqiptar. Fibank Albania është nga mbështetësit e parë të kësaj qendre që synon të ndihmojë familjet në nevojë, të moshuar të vetmuar dhe fëmijë, të cilët janë të përjashtuar për shkak të situatës së tyre sociale ekonomike të vështirë, të papunësisë, të dhunës, të neglizhimit apo të diskriminimit dhe nuk përfitojnë përkujdesjen apo shërbimet e nevojshme.

Punonjësit e Fibank u organizuan me personazhe të njohur të showbizit shqiptar dhe vullnetarët e Kryqit të Kuq, duke ofruar bujarisht shërbimin e tyre për këtë pjesë kaq vulnerabël të shoqërisë.

Nëpërmjet këtyre iniciativave Fibank Albania synon të rrisë ndjenjën e solidaritetit e mbështetjes së vazhdueshme në shoqëri si nga institucionet edhe nga çdo individ i saj! Aktivitetet e Përgjegjësisë Sociale të Fibank mbështesin lëvizjet shoqërore që sjellin ndryshime e përmirësime në planin afatgjatë, si mentaliteti dhe edukimi për të gjitha gjeneratat pa lënë mënjanë edhe aktet e bamirësisë.



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 632

SUPLEMENTI I PERJAVSHEM GAZE TA SHQIPTARE

Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 20 Tetor 2018



ANA KABASHI

Ish-konkurrentja e "Voice of Albania": Në fund nuk më vlerësuan



• **Rrëfëhet këngëtarja:**
Komplimenti më i pazakontë që më ka bërë një VIP. Së shpejti në RTSH edhe me një videoklip të ri të producentit amerikan

"AS NE ENDRAT E TUA", EINXHEL SHFAQET ME JOSHESE SE KURRE



STRESI & KEJSI

Mendohet se janë ndarë, ja prova që janë bashkë

"Bëhet e gjallë" e dashura e Stresit, reagon pas kapjes së reperit nga policia. "A do ia falësh tradhtinë?", Kejsi e ka një përgjigje për të gjithë kuriozët



• "PSE NË SHQIPËRI KA AKOMA RACIZËM?", RIKJA KËRKON TË DIJË • "HERA IME E PARË!", ARBANA PUBLIKON VIDEON HUMORISTIKE DUKE NGARË BIÇIKLETË FËMIJËSH • E PRISNIM PREJ KOHËSH, ALMEDA ABAZI PUBLIKON KËNGËN E SAJ TË PARË • IKU VERA? JOOO! VAJZA E ISH-DEPUTETES NDEZ INTERNETIN VESHUR ME BIKINI



E prisnim prej kohësh, Almeda Abazi publikon këngën e saj të parë

Ajo njihet si një nga miset më të bukura shqiptare që ka rrëmbyer zemrën dhe mbiemrin një prej aktorëve më të famshëm turk. Por jo vetëm kaq! Tashmë Almeda Abazi është edhe këngëtare. Modelja dhe prezantuesja e njohur tani ka filluar karrierën edhe si këngëtare. Ajo ka publikuar këngën e saj të parë, Alabama, që është në bashkëpunim me DJ e njohur turk, Burat Yeter. Kënga është në gjuhën angleze ndërsa Almeda vjen mjaft e ëmbël si në vokal ashtu edhe në videoklip. S'kishte se si të shfaqej ndryshe veçse si një kukull me një zë engjëlli.

Sërish bashkë! Genci dhe Eni Koçi vijnë me "Harrove"

Mesa duket bashkëpunimet mes tyre nuk kanë të sosur. Edhe pse nuk duan ta pranojnë publikisht lidhjen e tyre disa vjeçare tashmë, çifti Genc Prelvukaj dhe Eni Koçi duket se në heshtje duan të kthehen në "çiftin e fuqishëm". Kënga e radhës nga dyshja i dedikohet dashurisë, me një tekst të cilin e kanë shkruar të dy bashkë. Kënga ka titullin "Harrove", ndërsa është një baladë shumë e bukur. Videoklipi i veçantë e gjen dyshen duke u endur nëpër rrugët e bukura të Ohrit ndërsa kënga është produksion i Black Fish Entertainment. Të vështirë për t'u pranuar, por të bukur për t'u dëgjuar. Kur do të dalin më në fund hapur me dashurinë e tyre, apo do vijojmë të gjurmojmë fotot paparaci të çiftit?



Romanticitet apo shoqëri? Dafi poston foton e Noizyt nën dritën e hënës afër zjarrit

Pasi u rikthye këngëtarja, ata të dy gjejnë gjithnjë mundësinë për të qenë të pandarë në projektet e ndryshme muzikore. Dafina dhe Noizy duket se kanë filluar xhirimet për videoklipin e bashkëpunimit të tyre të radhës. Në bazë të postimeve që kemi parë nga të dy, artistët shihen në të njëjtin vend. Ata shihen që kanë kaluar kohë në natyrë, e madje edhe kanë ndezur një zjarr, ndërsa thuhet se Dafina dhe Noizy pikërisht në këtë vend kanë filluar të xhirojnë edhe videoklipin për këngën e tyre më të re. Dafina i ka bërë reperit një fotografi të cilën të dy e kanë shpërndarë në 'Instagram'-et përkatëse. Kurse për sa i përket këngës së shumëpërfolur duket se është drejt përfundimit.



Iku vera? Jooo! Vajza e ish-deputetes ndez internetin veshur me bikini

Edhe pse temperaturat janë ulur për shumë nga ne vera mbetet stina e preferuar dhe në një mënyrë apo në një tjetër gjejmë mundësinë të mos shkëputemi prej saj. Këtë gjë duket se ka bërë edhe modelja shqiptare Ada Deda. E veshur me bikini duket se për të stina e nxehtë nuk ka ikur ende. Me trupin në superformë ajo ka provokuar ndjekësit me fotot e publikuara së fundmi në Instagram. Vajza e ish-deputetes demokrate, Albina Deda ka pozuar me bikini duke treguar linjat e saj perfekte. Prej kohësh ajo kishte qëndruar larg këtyre postimeve sensuale, por tani që jemi në mes të stinës tjetër modelja ndihet nostalgjike.



“A e fal tradhtinë?”, Zaimina habit me përgjigjen e saj

Për kohësh këngëtarja bukuroshe është shprehur pa doreza sa herë që është pyetur lidhur me jetën e saj private. Më parë dinim thjesht që ishte në një lidhje jetëgjatë me dike ndërsa sot dimë shumë më shumë. Kjo sepse këngëtarja ndihet e lumtur me familjen e saj dhe e hapur ndaj publikut. Por në një pyetje pikante të bërë lidhur me tradhtinë ajo ka dhënë përgjigjen që askush se priste. Në promon e puntatës së kësaj të shtunë të “Shiko kush luan”, Zaimina i përgjigjet pyetjes “çfarë do të ndodhte nëse, larg qoftë, do t’ju tradhtonin partnerët.” “Jo, nuk do të ndahesha,” thotë ajo. “Po, do t’ia falja.” Kjo përgjigje ishte vërtetë dyshuese dhe e papritur e dhënë nga këngëtarja. Por për aq kohë sa ata ndihen mirë dhe të lumtur, askush s’ka pse të gjykojë mendimet e gjithsecilit.



Fjalë me vend, Kledi Kadiu flet për herë të parë për martesën

Balerini i njohur shqiptar dhe vajza me të cilën vendosi të ndante jetën, Charlotte lidhën kurorë qershorin e këtij viti. Balerina, që është dhe mësuese joge, duket arriti ta bindë më në fund Kledi Kadiun ta hedhë pas krahëve beqarinë e zgjatur. Diferenca e moshës mes tyre është e madhe, gati 20 vjet, por kjo nuk ka ndikuar aspak në marrëdhënien mes çiftit. Po çfarë mendimi ka Kledi për institucionin e martesës, të cilit i qëndroi larg për shumë kohë? Përgjigjen e jep me një pohim që flet shumë qartë. Martesa, tha ai për “Storie italiane”, “përfaqëson kurorëzimin, realizimin e çdo gjëje! Kam parë gjithçka që ishte jeta ime në të shkuarën, si dhe të tashmen e të ardhmen. Kam një bashkëshorte të bukur, një vajzë të bukur, kam një familje”, theksoi Kledi, i cili shtoi më tej se Charlotte, e bija dhe nëna, Lindita, i japin forcë për të ecur përpara.



Vijojnë dhuratat për djalin e Erjon Veliajt, “Tironcit më të ri në qytet”

Vetëm tri ditë më parë, kreu i Bashkisë së Tiranës, Erjon Veliaj ishte i pranishëm në qendrën komunitare që mban emrin “Gonxhe Bojaxhiu” në kryeqytet. Së bashku me personazhe të tjerë të njohur ai ka shërbyer një vakt për qytetarët e pranishëm në këtë qendër. Por gjatë vizitës në fjalë, dikush mesa duket ka uruar kryebashkiakun për lindjen e vogëlushit të tij, Kajjan, duke i dhuruar një palë papuçe të bëra me dorë. Në foton e postuar së fundmi në ‘Instasory’ duket kryebashkiaku sheh me buzëqeshje papuçet bojëqielli të dhuruara për djalin. Çifti Erjon Veliaj dhe bashkëshortja e tij Ajola Xoxa u bënë më datë 6 të këtij muaji prindër të një djali të cilin vendosën ta quanin Kajjan.



Qyteti i dashurisë fiton zemrat e VIP-ave tanë, çifti i njohur shijon romancën nëpër rrugët e Parisit

Të gjithë e njohim si qyteti i dashurisë Parisin, kryeqytetin e Francës. Mesa duket kjo dëshirë për pak aventurë dhe aromë romanticiteti i ka hipnotizuar shumë nga vip-at tanë. Këtë javë në Paris shkuar për të festuar ditëlindjen këngëtarja Enca me motrën dhe shoqërinë si dhe këngëtarët Beatrix dhe Alban Ramosaj së bashku me shoqërinë e tyre. Por vizitorë të tjerë shijuan aromën pariziene këto ditë. Po flasim pikërisht për çiftin e sapofejuar, Venera Lumani dhe Lind Islami. Një ndër çiftet më të pëlqyer në showbizin shqiptar me kiminë dhe sytë që i shkëlqejnë gjithë kohës sa herë janë pranë njëri-tjetrit. Vetëm para pak ditësh ata kanë udhëtuar drejt Parisit, dhe ndodhën ende atje duke shijuar historinë e tyre të dashurisë, në qytetin e dashurisë. Dysjha ka ndarë me ndjekësit foto dhe momente gjatë qëndrimit në Paris ku shfaqen më të lumtur dhe dashuruar se kurrë më parë. Në fakt, për të kuptuar dashurinë që këngëtarët kanë për njëri-tjetrin nuk ka nevojë për fjalë, mjaft t’i shohësh fotot e tyre bashkë dhe gjithçka kuptohet qartë. Eh, dashuria!

Rrëfihet këngëtarja: Komplimenti më i pazakontë që më ka bërë një VIP

Ish-konkurrentja e "Voice of Albania", **ANA KABASHI:** Në fund nuk më vlerësuan

"Së shpejti në RTSH edhe me një videoklip të ri të producentit amerikan"

Ajo është një nga vajzat e talentuara që spikati që në fillim në skenën e "The Voice of Albania", pesë vite më parë. Por, që atëherë e deri më sot pasioni i saj për muzikën nuk u ndal në atë kom-peticion. Ana Kabashi, këngëtarja bukuroshe nga Kosova vjen në një rrëfim ekskluziv për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" lidhur me eksperiencat e saj të reja në fushën e muzikës. Lidhur me konkursin e "The Voice", ajo ka thënë për herë të parë se nuk është ndjerë e vlerësuar, ndërsa për-sa i përket karrierës së saj muzikore, shumë shpejt do të sjellë në tregun shqiptar një këngë e realizuar nga producenti i një prej këngëtarëve më të famshëm amerikanë, Drake. Këto e të tjera në inter-vistën e mëposhtme.

Pamela Aliaj

Keni nisur rrugëtimin tuaj në "The Voice Albania", ku dhe ju ndihmoi të plotësonit identitetin tuaj si këngëtare. Si nisi dashuria juaj për muzikën?

Dashuria për muzikën ka filluar që në fëmijëri, ku gjith-monë isha duke kënduar dhe vallëzuar.

Pas këngës së fundit të lançuar, "Bla Bla Boy", cili është projekti i radhës i Anës?

Pas këngës "Bla Bla Boy" do të lançoj një duet me një këngëtar internacional. Por, nuk mund ta zbuloj që tani se për kë bëhet fjalë.

A është bazuar kënga juaj në një eksperiencë të jetuar nga ju?

Kënga e fundit është bazuar në realitetin tim dhe besoj se secilës femër i ka ndodhur një rast i tillë.

Nga u frymëzuat për tekstin dhe muzikën?

Për tekstin jam frymëzuar nga jeta personale, ndërsa vijën melodike e realizova duke shkruar dhe kënduar në



të njëjtën kohë dhe është krijuar vija melodike.

Cili është thashethemi më i madh i bërë për ju që ka qenë absolutisht gënjeshtër?

Thashethemi më i madh ka qenë që unë punoj në Beograd, por nuk e di se çfarë pune bëj. (Qesh) Edhe pse unë s'kam qenë asnjëherë në Beograd, kështu që ky ka qenë thashethemi më me pa kuptim që kam dëgjuar ndonjëherë.

Së fundi folët për një propozim të bërë nga një producent nga SHBA. Për çfarë bëhet fjalë konkretisht? A keni nisur xhirimet?

Me producentin nga SHBA kam realizuar një këngë, që shumë shpejt keni për ta dëgjuar dhe do të shihni





edhe videoklipin.

A është ndërre ndonjëherë e jo vlerësuar Ana në performancat e saj në "Voice" apo dhe më gjerë?

Në "The Voice" vetëm performanca e fundit mendoj që nuk ka qenë e drejtë për gjykim. Por çdo gjë ndodh për një arsye, kështu që s'e kam marrë personale. Ndërsa për vendet e tjera, nuk është se kam marrë pjesë në koncerte apo festivale garuese, por nga çfarë kam dëgjuar nga kolegët e mi, nuk bëhet vlerësimi sipas meritës së vërtetë.

Së fundmi thatë se do të merrnit pjesë në festivalin e këngës në RTSH për në Eurovision. Pse ky vendim? A e keni bërë përgatitjet për këngën?

Ëndrra e secilit këngëtar besoj se është skena e mad-

he e Eurovizionit. Gjithmonë e kam menduar dhe tani vendosa të marr pjesë. Kënga akoma s'është vendosur se cila do të jetë, por kam shumë opsione zgjedhjeje.

Për çfarë flet kënga?

Nuk mund ta zbuloj që tani se për çfarë flet kënga.

Baladat zakonisht kanë qenë fitimtare, ashtu si ajo e Rona Nishliut në Eurovision, që zuri një vend shumë të mirë.

Balada e Rona Nishliut është

të një ndër baladat më unike në botë dhe s'besoj që dikush mund t'ia kalojë me diçka tjetër e jo më me baladë.

Cili është zhanri i këngës që i përshtatet plotësisht Anës?


Nuk kam ndonjë zhanër të caktuar, por mund të them se e gjej veten në shumë zhanre.

Jeni tepër e rezervuar me jetën tuaj private dhe s'para pëlqeni të ekspozoheni. A është dikush në jetën e Anës?

Po, jam e rezervuar, sepse sa më shumë njerëz të jenë të përfshirë në jetën time, private aq më shumë problem do të kem. Ndosh-ta edhe e kam dikë në jetën time personale, por që s'mund të them asgjë të sigurt tani.

Cili ka qenë komplimenti më i ekzagjeruar që keni marrë nga një VIP?


Komplimenti më i ekzagjeruar ka qenë: Je si raketë ruse. (Qesh)



“Hera ime e parë!”, ARBANA publikon videon humoristike duke ngarë biçikletë fëmijësh

Nëse nuk e keni mësuar ende biçikletën mos u shqetësoni se nuk jeni vetëm. Mesa duket, moderatorja e njohur e Top Chanel, Arbana Osmani është shokë me ju. Deri pak kohë më parë ajo s'i kishte hipur ndonjëherë biçikletës dhe nuk kishte preferuar ta mësonte ta ngiste. Por mesa duket tashmë ka ndërruar mendje.

Moderatorja ka kaluar pasditen e së premtes me familjarët e saj në një park në Tiranë. Dhe Arbana nuk i ka rezistuar dot tundimit për të mësuar biçikletën, ndaj ia ka nisur nga zero! Pra, nga biçikletat me tre rrota, që janë për fëmijët e vegjël. E veshur me pantallona të zeza dhe një xhakëtë xhinsi, Arbana shfaqet e ulur në biçikletë në videon e bërë publike në “Instagram”, por nuk niset pa kërkuar ndihmën e të vëllait. “Hera ime e parë në biçikletë” – shkruan Arbana poshtë videos së bërë publike, ndërsa familjarët shpërthejnë në të qeshura. Më mirë vonë se kurrë apo jo?





“As në ëndrrat e tua”, EINXHEL shfaqet më joshëse se kurrë

E dhe pse prej një kohe të gjatë tashmë është shkëputur nga ekrani, bukuroshja Einxhel Shkira vijon të jetë në qendër të vëmendjes me postimet e saj në rrjetet sociale. Së fundmi Einxhel ka postuar një foto ku tregon lëkurën e nxirë dhe tatuazhin egjiptian në formën e syrit të quajtur “Syri i Horusit” në mitologjinë egjiptiane, i cili simbolizon perëndinë-fajkua Horus, diellin dhe perëndinë-diell Ra, mashkullorësinë dhe matematikën. Pamja e tij i ngjan një skifteri. Syri i majtë simbolizon Perëndinë Tot, Hënë, intuitën dhe feminitetin. Syri i majtë dhe i djathtë kombinohen për të përfaqësuar të gjithë universin, pak a shumë si simboli i Yin-Yang në Taoizëm. Syri i Horusit thuhet se ka aftësi shëruese dhe është përdorur si një hajmali që mbron nga e keqja. Mbi foto bukuroshja shkruan “As në ëndrrat e tua!”. Pra, me hajmalinë në trup dhe tipin rebel askush nuk guxon t'ia thyejë zemrën. E mirëmunduar si ide apo jo? Djema, s'keni shanse me Einxhelin, e keni të kotë!

“Pse në Shqipëri ka akoma racizëm?”, RIKJA kërkon të dijë

Ajo spikati para pak vitesh në një nga reality show-t më të famshme në Shqipëri, “Big Brother Albania”, ndërkaq edhe pse tashmë jeton jashtë vendit, vëmendja ndaj saj nuk është zbehur aspak. Po flasim pikërisht për ish-banoren simpatike nga Durrësi, Rike Roçi, e cila nuk kaloi pa tërhequr vëmendjen me pamjen e saj tepër tërheqëse. Por përveç lëvdatave, Rikja mund të ketë hasur edhe elementë racizmi në Shqipëri dhe për këtë ka dashur të dijë opinionin e fansave të saj. “Pse në Shqipëri ka akoma racizëm?”, pyet Rike. Ndërkaq të shumta janë përgjigjet që tregojnë opinionin e ndjekësve për prapambetjen e shqiptarëve në mentalitet. Realiteti i hidhur i këtij vendi largon shumë për në vende të tjera. Të jetë Rikja një prej tyre?



Majtas apo djathtas? Fansat i zgjedhin BEBE REXHËS veshjen për paraqitjen tek Jimmy Kimmel

Këngëtarja shqiptare me famë botërore, Bebe Rexha ashtu si çdo person tjetër i famshëm është në kontakt pothuajse të vazhdueshëm me fansat e saj ku shpesh edhe kërkon opinionin e tyre. Së fundmi ajo i ka pyetur se çfarë duhet të veshë për t'u paraqitur në emisionin shumë të shikuar amerikan. Këngëtarja ka marrë pjesë në emisionin e prezantuesit të famshëm, në ‘Jimmy Kimmel Live’. Për atë natë ajo i ka lënë fansave në dorë të marrin një vendim të rëndësishëm. Bebe në ‘Instagram’ i ka pyetur ata cilën veshje duhet ta veshë, e siç duket këngëtarja i ka dëgjuar fansat dhe ka zgjedhur fustanin e zi mjaft të veçantë në vend të pantallonave e korsetit e këmishë të bardhë. Një zgjedhje me shije dhe e zgjuar!



“A do ia falësh tradhtinë?”, Kejsi e ka një përgjigje për të gjithë kuriozët

Mendohet se janë ndarë, ja prova që Kejsi dhe Stresi janë bashkë

“Bëhet e gjallë” e dashura e Stresit, reagon pas kapjes së reperit nga policia

Pamela Aliaj

Prej më tepër se një javë po bën bujë kapja e reperit të njohur, Arkimed Lushaj, i njohur ndryshe me emrin e skenës si Stresi. Ai u vu në pranga ditën e enjte në një prej hoteleve të rrethinave të kryeqytetit me një 20-vjeçare me inicialet P.Ç.. Kjo sipas të dhënave të regjistruara nga policia e Tiranës, e cila e arrestoi reperin midis çarçafëve të krevatit për trafik droge dhe krime kundër personit. Ai ishte nën përgjim prej disa muajsh dhe ishte kapur teksa komunikonte me disa persona për trafikun e drogës. Po kështu, në përgjimet ambientale dhe ato telefonike, Stresi është kapur duke orientuar shitësit të çojnë drogë në disa vende kryesisht lokale. 20-vjeçarja e cila e shoqëron-



te është lënë e lirë pas marrjes në pyetje. Ndërkohë që pak kohë më parë, ai bëri publike fejesën me të dashurën e tij, Kejsi, me të cilën kishte një lidhje disavjeçare. Dhe akoma më çudi bëri fakti i postimit të disa dokumenteve në “Instastory”-n e Kejsit, ku tregohet se ishte celebruar tashmë me reperin dhe mbante mbi emrin e tij. Por në momentin kur të gjithë prisnin që ajo “të zhdukej” pa lënë gjurmë nga rrjetet sociale, apo edhe të hiqte çdo foto që e lidhte sadopak me Stresin,

ndodhi ajo që askush nuk e priste. Pas të gjitha këtyre ndodhive, Kejsi e ka marrë me sportivitet këtë fakt, pasi ditën e djeshme ajo ka reaguuar nëpërmjet një statusi në “Instagram”, ku ka publikuar një foto në profilin e saj, teksa fokuson unazën në gishtin e martesës. Ajo që pritej nga të gjithë është reagimi i komentuesve, duke dashur të dinin më tepër lidhur me çiftin. Por nuk kishin si të mungonin edhe pyetje të tipit “Çfarë ka ndodhur mes jush”? “A do ia falësh tradhtinë”? Ndërkaq, po të shohin me vëmendje në profilin e saj, bukuroshja jo vetëm që nuk e ka hequr unazën e fejesës, por gjithashtu as fotot e vjetra që e lidhin me reperin. Ndërkaq, në ko-

mentet e mëparshme të bëra me mikeshat e saj nëpër foto, Kejsi thotë se do të qëndrojë shumë pak në Ottaëa të Kanadasë, që do të thotë se shumë shpejt bukuroshja do të rikthehet në Shqipëri (gjithnjë nëse është larguar prej saj). Gjithashtu, marrëdhëniet me mamanë e reperit shkojnë më së miri dhe kjo shihet në një koment të bërë në fillim të muajit tetor. Pra, rrin të qetë të gjithë, sepse Kejsi dhe Stresi nuk janë ndarë. Pavarësisht të gjithave, ata vijojnë të jenë bashkë dhe këtë e tregon më së miri vajza me reagimet e heshitura të bëra nëpër rrjetet sociale. Pra, pavarësisht gjithçkaje, dashuria triumfon.

Opinion i Ditës

Nga Ilir Kalemaj

(vijon nga faqja 1)

...e rreme kanë një histori mjaft më të hershme. Për shembull, një master i manipulimit mediatic të themi, ka qenë Pietro Aretino që kompozonte sonete fyese mbi kandidatët për papë në 1522 dhe i postonte në buletinën e shpallur pranë "Piazza Navona" në Romë. Këto soneta që i postonte nën një pseudonim "Pasquino", u quajtën "pasquinades" dhe u bënë një zhanër mjaft popullor, që vazhdoi deri në shekullin e 18 dhe nga Roma u përhap në Paris dhe më gjerë. Në fakt, aq shumë progres që bërë deri atëherë, sa një kategori e re "novelistët" ishin ara që përhapnin thashethemet zyrtare, që kombinon pak të vërteta dhe shumë gënjeshtër nëpërmjet librave dhe gazetave klandestine. Ndërsa rreth fundit të shekullit 18-të, në Londër nisën të publikoheshin pararendësit e tabloidëve të sotme, revista skandalesh siç quheshin asokohe dhe fshikullonin personazhe publikë.

Por, nuk duhet të harrojmë që shpesh liria e fjalës së shkruar është mbrojtur edhe nëpërmjet logjikës që lajmi nuk është çfarë realisht ka ndodhur, por një histori apo narrativë mbi atë që ka ndodhur, pra filtrat apo sjet me të cilat e sheh gazetari apo narratori, por ky është një debat më vete. Qysh herët liria e shprehjes i është bashkangjitur Kushtetutës amerikane nëpërmjet amendamentit të parë në 1791 dhe mandej është bërë pjesë esenciale e kushtetutave në vendet që sot kategorizohen si demokraci liberale. Është një nga të drejtat apo liritë esen-

Lajme të rreme, apo autoritarizëm i maskuar



cialle, bashkë me të drejtën e jetës, lirinë e gëzimit të pronës private dhe për të votuar. Në fakt, qysh me shpikjen e 'World Wide Web' nga Tim Berners-Lee në 1990-ën, nga një anë kemi akses të demokratizuar dhe pjesëmarrje në agorën publike të çdo individit, që ka diçka për të thënë apo një audiencë për ta dëgjuar, duke mos përjashtuar as "bu-

dallain e lagjes", që siç përmend me thumb Umberto Eco, dikur dëgjohej vetëm në pijetoren e lagjes dhe tashmë nuk është çudi të ketë edhe audiencë globale. Pra, edhe hapësirë demokratike dhe pjesëmarrje duke iu kundërvënë njëfarësoj monopolit të elitave, por edhe me riskun që çdo lloj narcizi, grafomani apo thjesht idioti do ta keepërdorë ak-

sesin për të shpërhapur dezinformacion, lajme të rreme apo thjesht de- lire, që nuk shtojnë gjë në kandin e arsyes. Sikundër shkruan Tom Nichols në librin e tij "Vdekja e Ekspertizës", ka një bindje të përhapur mes qytetarëve të zakonshëm, që opinioni i tyre është po aq i mirë sa edhe i çdokujt tjetër dhe kjo shtyn drejt një mosbesimi kolektiv ndaj

teknokratëve dhe ekspertëve në fusha të ndryshme. "Vdekja e ekspertizës" përkon jo pak herë me rritjen e populizmit, i cili mund të rezultojë po aq i dëmshëm për demokracinë, po aq sa ana tjetër e medaljes: autoritarizmi. Ky i fundit shpesh vjen i maskuar nën kërcënimin e proceseve ligjore dhe gjyqësore, nën maskën arrogante të kërcënimit të "shkopit" apo nën incentivizimin ëmbësues të "karotës", por ngelet po aq diabolik dhe i rrezikshëm në të dyja rastet. Natyrisht, faktet janë fakte dhe 'ingorantia non excusat'. Ky është një apel dhe për kapardisësit e ekraneve, që flasin rroma për-toma, apo siç thotë populli "kodra pas bregut", pa u thelluar në vërtetësinë e lajmit, pa verifikuar burimet, pa bërë gazetari investigative dhe kështu me radhë. Por çdo përgjegjësi është e ndarë dhe kjo nuk do të thotë që dikush mund t'i heqë dikujt të drejtën e mendimit, opinionit apo analizës në një shoqëri të lirë dhe demokratike. Siç thoshte mençurisht ish-senatori dhe sociologu i famshëm amerikan, Daniel Patrick Moynihan: "Secili ka të drejtën e opinionit të tij, por jo edhe të fakteve të tij". Thënë kjo, çdo lloj kërcënimi për agjitacion i maskuar si mbrojtje ndaj së vërtetës, të vërtetës së pushtetit, është një kërcënim për demokracinë dhe liritë esenciale të individit dhe e çuar më larg mund të shtyjë drejt një të ardhmeje distopike të paralajmërimeve Orwelliane, ndonëse teorikisht do vijojmë të quhemi demokraci.

THASHETHEME MADE IN ALBANIA

BLUE TOOTH

THASHETHEME MADE IN ALBANIA

Te gjitha te rejat nga jeta e vipave

e V

çdo të shtunë falas me GAZETA SHQIPTARE

Opinion i Ditës

Sikur opozita të thellohej në raportet e KLSH!

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

...të problematikës së sotme të financave tona publike. Krahas evidentimit të të metave të konstatuara, ai synon përmirësimin e qeverisjes publike, sidomos rritjen e përgjegjësisë së strukturave vendimmarrëse qeveritare, duke zbatuar standardet ndërkombëtare të raportimit të treguesve makroekonomikë, si niveli i borxhit, i deficitit buxhetor, etj. Institucioni ka audituar përputhshmërinë e hartimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të Buxhetit të Shtetit. Gjetjet e KLSH-së, nëse do të lexoheshin me vëmendje nga opozita jonë, do të përbënin një aset të vyer të vënies përpara përgjegjësisë të strukturave qeveritare. Dhe, sikurse KLSH e ka përsëritur në vijimësi çdo vit në paraqitjen në Kuvend të këtij raporti auditimit jetik për mbarëvajtjen e financave të Shtetit, përgjegjësia për suksesin apo mospërfundimin e financave publike nuk duhet lënë kurrsesi vetëm në personin e ministrit të Financave.

Shëndoshja dhe garantimi i qëndrueshmërisë së treguesve kryesorë financiarë është një punë dhe përgjegjësi e përbashkët. Asnjë nga ministrat e linjës ose institucionet e tjera qendrore të pavarura nuk mund të lajmë duart si Pons Pilati, përpara përkeqësimit të këtyre treguesve. Shqetësimi kryesor i KLSH-së në raportimin e zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin e kaluar, i shprehur i plotë në opinionin e auditimit, bazuar në standardet ndërkombëtare të fushës, IS-SAI-t, është se për disa zëra buxhetorë, përfshirë nivelin e deficitit dhe borxhit publik, institucioni ka konstatuar devijime materiale (sasiore dhe cilësore) në drejtim të hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit jo në përputhje me ligjet financiare të shtetit. KLSH e thekson rritjen shqetësuese të detyrimeve të prapambetura sërish (kujtojmë eksperiencën e hidhur të viteve 2012-2013.

Në vitin 2013, në paraqitjen e raportit të zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2012, KLSH, përpara FMN-së dhe Bankës Botërore theksoi riskun e akumulimit të këtyre detyrimeve për Buxhetin). Sipas saj, ato janë jo më pak se 19 miliardë lekë, ose 152 milionë euro. Këto detyrime të prapambetura nuk janë raportuar në tabelën e treguesve fiskalë, por janë konsideruar si shpenzim i periudhave të ardhshme, duke mbajtur artificialisht të ulët deficitin buxhetor. E njëjta gjë edhe për treguesin e borxhit publik, i cili nëse konsiderohet edhe detyrimi për rimbursim i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (i TVSH-së në 11 miliardë lekë ose 88 milionë euro), shkon në nivelin 72% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të vendit. Kjo është mjaft shqetësuese, kur në strategjinë "Për Menaxhimin e Fi-



nancave Publike 2014-2020", e përgatitur për të realizuar qëndrueshmërinë dhe shëndoshjen e financave tona publike, objektivi i uljes së borxhit publik në fund të vitit 2017 ka qenë 65.5% e PBB(!). Pra, jemi afro 7 për qind ose mbi 1 miliard euro prapa! Ndërkohë, shpenzimet nga Buxheti i Shtetit për pagesat për koncesionet e tipit PPP (Partneritet Publik-Privat) nuk futen në borxh. Këto lloj kontratash përfshijnë detyrime disaveçare të Buxhetit të Shtetit, shpenzime këto të domosdoshme për realizimin e projekteve të miratuara.

Vetëm për vitin 2017, shpenzimet e Buxhetit të Shtetit nga 11 tipa të tillë kontratash koncesionare ishin rreth 6,45 miliardë lekë,

ose mbi 51 milionë euro. Këto shpenzime do të vijnë vetëm duke u rritur, duke arritur në vitin 2021 në 144 milionë euro. Një barrë e rëndë, problematike për Buxhetin tonë. Për këto arsye, KLSH-ja ka rekomanduar që në planifikimin dhe realizimin e treguesve të borxhit të merren në konsideratë këto kosto financiare që mbartin projektet PPP Ndërkohë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk i raporton këto shpenzime në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, që kërkojnë që të tilla kontrata të raportohen në stokun e borxhit publik.

Disiplinimi i financave publike, shmangja e devijimeve në raportimin e treguesve financiarë, si dhe zbatimi i rekomandimeve të

përsëritura ndër vite (rekomandimi i KLSH-së për uljen e borxhit publik daton që në vitin 2012) duhet dhe gjithnjë është e mundur të jenë kuaj beteje për opozitën tonë. KLSH-ja si institucioni i depolitizuar dhe që respekton standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t nuk mund të prodhojë politika. I takon politikës, në radhë të parë opozitës që ta bëjë. Të thellohet në këto raporte auditimi, që i japin lëndë të parë të mrekullueshme për të sfiduar pozitën, duke prodhuar opozitarizëm të mirëfilltë konstruktiv dhe duke fituar pikë tek qytetarët, pasi përmirësimi i treguesve të financave publike ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e shërbimeve publike dhe të nivelit të jetesës së çdo shqiptari.

HOROSKOPI

DASHI

Kjo ditë do të jetë shumë e mirë për të lindurit në shenjë tuaj. Raportit sentimental kushtojini më shumë vëmendje. Në familje do të keni një marrëdhënie pozitive.

DEMI

Ana fizike do të jetë e mirë, për shkak të aktiviteteve fizike. Është një moment shumë i mirë për të lindurit e kësaj shenje, sidomos në dashuri.

BINJAKET

Raportit me partnerin ka nevojë për më shumë vëmendje. Duhet të organizoni më mirë ditën tuaj të punës, pasi do të përballeni me disa probleme.

GAFORJA

Në punë do të keni lajme të mira. Kolegët do t'ju ndihmojnë të çoni përpara një çështje me rëndësi. Raportit me personin që doni është disi i turbullt.

LUANI

Me partnerin do të keni disa përplasje, por në fund do të triumfojë dashuria. Puna juaj më në fund do të vihet re, duke bërë që të merrni meritat që meritoi.

VIRGJERESHA

Situata ekonomike nuk është shumë e mirë. Ndoshta ka ardhur momenti që të mendoni alternativa të tjera pune. Familja juaj do të mbështesë çdo zgjedhje të bërë.

PESHORJA

Sa i përket fushës së ndjenjave, do të arrini të kaloni momente pozitive me personin që doni. Do të keni një ditë pozitive, por shumë të ngarkuar.

AKREPI

Parashikohet një situatë jo fort e mirë sa u përket parave. Nuk bëni keq nëse kurseni për ditë e vështira. Gëzojuni dashurisë që ju ofron partneri.

SHIGJETARI

Në pjesën e parë të ditës mund të përballeni me të papritura të pakëndshme në punë. Një koleg që nuk i ka aftësitë tuaja mund të shfaqet si pengesë për ju.

BRICJAPI

Një eksperiencë negative në dashuri ka bërë që ta humbisni besimin tek kjo ndjenjë. Mos hiqni dorë shpejt, sepse yjet ju favorizojnë në këtë fushë.

UJORI

Një telefonatë e rëndësishme që mund të ketë lidhje me një vend pune mund t'ju bëjë ditën më të bukur. Mendojeni seriozisht, nëse merrni një propozim të tillë.

PESHQIT

Një histori dashurie e shkurtër shfaqet në sfond për të lindurit në këtë shenjë. Këshilloheni që ta ndërmerrni çdo hap me kujdes, sepse gjërat mund të shkojnë sipas planit.

Paditi ish-presidentin Nishani

Panuçi nuk paraqitet në gjyq, gjobitet nga shteti

Trajneri i përfaqësueses shqiptare, Kristian Panuçi ka hedhur pak kohë më parë në gjyq ish-presidentin Bujar Nishani, pasi mendon se çdokush duhet të mbajë përgjegjësinë që i takon para ligjit për atë që thotë apo që bën. Por me sa duket, trajneri vetë nuk është edhe aq korrekt me detyrimet ligjore, pasi pak ditë më parë nuk është paraqitur në një gjyq në Itali, ku i ishte kërkuar të



bëhej dëshmitar. Gjyqi është hapur ndaj një shtetasi italian, Alesio Cicerò, i cili në vitin 2011 në Maldive vodhi disa foto të Françesko Totit dhe Ilari Blazit të shkrepura ndërsa ishin me pushime dhe më pas ua shiti gazetave të 'gossip' në

Itali. Personit të cilit ai ia kishte marrë pa leje fotot, ishte një regjisor i njohur italian, Mauricio Katalani, i cili ishte mik me çiftin dhe ua kishte shkrepur për t'i pasur si personale. Panuçi, i cili kishte qenë asokohe me pushime në të

njëtin lokalitet turistik, kishte qenë në dijeni të fakteve pasi i njëjti të gjitha palët e përfshira. Regjisorin italian është ai i cili ka hedhur në gjyq Cicerò, i cili i kishte marrë aparatit fotografik për të tërhequr disa foto që i kishte

bërë edhe atij dhe kishte shfrytëzuar rastin për të vjedhur fotot e Totit dhe bashkëshortes së tij. Kësisoj, Panuçi ishte ftuar që të dëshmonte në gjyq, por nuk është paraqitur në sallën e gjykatës në Trapani. Kjo ka bërë që gjykatësi Fabio Orreste Marroko të gjobitë me 250 euro trajnerin e Shqipërisë dhe të kërkojë që të paraqitet në seancën e radhës për të dhënë versionin e tij të ngjarjeve si dëshmitar para drejtësisë.

Trajneri shkodran vlerëson lojërat e mira dhe beson se pikët do të vijnë shumë shpejt



Jeton Selimi

Cungu: Kukësi nuk ka asgjë më pak se rivalët

Stadiumi, problemi më i madh për verilindorët

Armando Cungu beson te Kukësi i tij, pavarësisht rezultateve negative të arritura ndaj rivalëve kryesorë për titull, Skënderbeut dhe Partizanit, ndaj të cilëve verilindorët u mposhtën me të njëjtin rezultat, 1-0. Pas ndërprerjes së kampionatit, nënkampionët e sezonit të shkuar do të luajnë ndaj Kastriotit dhe synimi janë vetëm 3 pikët për të përfituar nga hapi fals i kryesuesve të renditjes.

Si paraqitet gjendja e ekipit në prag të ndeshjes me Kastriotin?

Nuk ka shqetësime dhe e kam theksuar që pavarësisht rezultateve, kemi bërë lojë të mirë dhe dominuese.

Si vjen Kukësi pas ndërprerjes së kampionatit?

Aspekti psikologjik është i lartë, pasi po krijojmë raste dhe nuk po shoh ekip më të fortë se Kukësi për momentin. Pushimet janë pozitive dhe kanë ndihmuar këtë periudhë dhe lojtarët mund të marrin më shumë ngarkesë, por edhe janë përmirësuar ato me gjendje jo të mirë fizike. Ndeshja me Kastriotin është delikate dhe nuk shoh ekipet të lehta në letër. I bëj me dije djemtë të jenë koshient dhe mos të kenë nënvlerësim pasi nuk ka vend.



Luani ndaj vendit të fundit në renditje

Nuk e kam problem të përgatis ndeshjen në aspektin sportiv, por është e vështirë për motivimin në ndeshje të tilla,

pasi ndaj Skënderbeut janë vetë të motivuar. Eksperienca ka treguar se nëse ndeshjet merren lehtë, duhet menduar për kundërshtarin. Djemtë e kanë kuptuar ndeshjen e

radhës. Do të ketë ndryshime në formacion, pasi ka pika ku duhet ndryshim dhe duhet parë pikat më të mira. Duhet krijuar stabilitet!

Kundër pretendentëve nuk kanë ardhur fitoret...

Ishin rezultate zhgënjyese, por nuk është shume zhgënjim kur humb në Korçë. Lojtarët ishin bindës dhe na zhgënjën vetëm pikët e lëna. Ndeshjen e radhës nuk duhet ta marrim me presion, pasi 3 pikët janë oksigjen dhe duhet të luajmë qetë. Më se e bëjmë gjithçka mirë do të marrim më të mirën.

Si është marrëdhënia juaj me Rexhinaldon?

Jam përgjigjur vetëm pyetjeve dhe më vjen keq që tjetërsohen vendet dhe nuk kam fyer askënd. Kam thënë fjalë maksimale kur ka prezencë të mira dhe do të ketë kritikë. Nuk kam sulmuar individë të caktuar, ndërsa më vjen keq

për përktimin që i është bërë Rexhinaldos.

Kukësi ka krijuar raste të shumta shënimi, por pa arritur të konkretizojë.

Pas Partizanit, kam kërkuar nga lojtarët që të japin më tepër kontribut, pasi në shumë ndeshje humbim të paktën 4 raste për gol. Presim nga ndeshja në ndeshje dhe nga java në javë të shënohen gola. Gjeografia e shpërndarjes së golave duhet të jetë e barabartë. Kanë të gjithë të drejtë të shënojnë, pasi si Cuculli e Shameti kanë kontribuar me gola.

Sa e ndjen ekipi mungesën e tifozëve?

Fakti që kemi bërë lojë të mirë do të thotë që ka ndryshuar ekipi, por në dy javët e fundit kishim përballë dy rivalë direkt, por nuk kemi gje më pak. E vetmja gjë që kemi më pak është stadiumi dhe tifozë.

Kampioni Khabib zgjedh Majk Tajsonin si trajner

Khabib Nurmagomenov arriti një fitore të merituar në duelin e shekullit përballë irlandezit, MekGregor. Luftëtari që përfaqëson ngjyrat e Rusisë tashmë duket se ka sfiduar legendën amerikane të boksit, Floyd Mejujdhër, i cili ka plot 50 fitore dhe asnjë humbje në sportin e boksit. Por sipas asaj që bëjnë me dije mediat britanike si "The Sun", Nurmagomenov i ka bërë ftesë legendës së boksit, Majk Tajson që të jetë trajneri i tij në këtë sfidë. Megjithatë, ende nuk kemi një zyrtarizim të kësaj sfide.

Mbrojtësi i pas dëmtimit

Rrumbullaku: Kukësi pretendet bashkë me Partizanin dhe Skënderbeun




munguar fati. Ekipi ka qenë mirë pasi ka gabime në futboll, por ne duhet të

bëjmë sa më pak për të arritur qëllimin që kemi. Jemi përgatitur shumë për këtë ndeshje dhe nuk ka ekipet të lehta. Partizani nuk ka zhvilluar lojë shumë të madhe, por ka grup. Nuk duhet harruar as Skënderbeu që është ekip me emër. Të flasim tani për titullin është rruga shumë e gjatë. Na merrzin këto rezultate, por duhet të punojmë më shumë dhe të jemi më të fortë.

Gramshioti mbetet i kuq

Partizani "blindon" Trashin deri në vitin 2020




kontratën e re deri në 2020, me opsion rinovimi edhe për 1 vit tjetër, duke

konkretizuar kështu pozitivist të ardhmen e titullarit te Partizani. Trashin pjesë e të kuqeve nga viti 2014, falë paraqitjeve dhe cilësive që ka shfaqur përfaqësi të eksperiencës me fanellën e kuqe, konsiderohet një prej lojtarëve më të spikatur të Partizanit dhe kampionatit tonë. Rinovimi i kontratës erdhi me dëshirën e të dyja palëve, fakt i cili pasqyron më së miri besimin dhe korrektesinë e marrëdhënies klub-lojtar", shkruhej në postimin e klubit.

Gjatë konferencës për shtyp të Kukësit, foli edhe Simon Rrumbullaku, që rikthehet në fushën e lojës pas një muaji e gjysmë dhe u shpreh se është gati për sfidën e radhës. "Në fillim menduam se ishte i lehtë, por jo, pasi kisha plagë në gju dhe ishte e vështirë të mbyllej. Ky pushim më ka bërë mirë dhe tani jam gati për skuadrën. Nëse luaj ose jo, e vendos trajneri. Nga futbollit jetojmë dhe të gjithë duam të luajmë, por kështu e ka futbollit dhe ka dëmtime. Duhet të rikthehemi më të fortë. Kukësi i ka cilësitë dhe lojtarë që mund të bëjnë diferencën. Ne dy ndeshjet e fundit na ka

Fjalëkryqi (1)



- 39. Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- 41. Kalimi në ekstreme.
- 42. Eshhtë e re pas Krishtit.
- 43. Shkruhet për të mos vazhduar më.
- 44. Si i gjithë.
- 47. Kush e thotë lutet.
- 48. Kufij elementi.
- 49. Ishte nÿja që preu Aleksandri i Madh.
- 50. Një pjesë e titanëve.
- 51. Mund të jetë kundërmuese.
- 52. Pak titanike.

VERTIKAL

- 1. Si i përshatëshëm.
- 2. Mund të jenë fetare.
- 3. Ai i kuq e ka një huq.
- 4. Pak analogji.
- 6. Eshhtë metri i rrobaqepësit.
- 7. Në hyrje të oazit.
- 8. Arte pa re.
- 9. Arthur që qe dramaturg.
- 10. Janë boshte.
- 12. Michelangelo regjisor.
- 14. Mund të bëjë stil të lirë .
- 16. Ishin monedhe te Tobias.
- 17. Eshhtë bas me katër tela.
- 18. Pak efikasitet.
- 22. Eshhtë marrëveshje me nota.
- 25. Ishte babai i Akilit.
- 26. Fillojnë nazet.
- 27. Në krye të kuadrove.
- 29. Eshhtë faqe muri.
- 30. Një apendisit i menjëherëshëm.
- 35. Kurosawa që qe regjisor.
- 36. Vriten nga espada.
- 37. Eshhtë shtet aziatik.
- 38. Edouard piktor.
- 40. Një transporti është kamioni.
- 45. Uni i Freud.
- 46. Një cigan.
- 47. Fundi i një samurai.

HORIZONTAL

- 1. Mund të jetë kursimi.
- 5. Ylli i Nostradamus.
- 8. Tamam pa kufij.
- 11. Ross këngëtare.
- 13. I lashtë.
- 15. Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- 19. Kufijtë e lëvizjes
- 20. I ka tek plepi.
- 21. Paguhen për shërbim.
- 23. Fillojnë lejen.
- 24. Kufizojnë trotualet.
- 25. Bëjnë karrierë në parti.
- 27. Thahet me bonifikim.
- 28. Mund të jetë unik një i tillë .
- 29. Preka komik shokdran.
- 31. Fund dhjetori.
- 32. Fillojnë aksionin.
- 34. Agjenci Operative Tiranë
- 34. Agjenci Ajrore Durrës.
- 36. Një pjesë e dimensioneve.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- 1. Fillojnë panikun.
- 3. Gibson aktor.
- 5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- 9. Mund të jetë trofe.
- 11. Janë vendet si Katari
- 14. Maureen që qe aktore.
- 16. Janë kundërmuese.
- 17. Mund të fitojnë etapa.
- 20. Ushtojnë nga "ola".
- 22. Një thirrje.
- 26. Janë ministritë.
- 27. Një rrugë në Paris.
- 28. Markë cigareje.
- 29. Eshhtë ngjinja.
- 32. Ricciarelli soprano.
- 33. Fillojnë sefte.
- 34. Ente Ekonomike Sarandë.


- 35. Mbyllin një ditar.
- 36. Satelit i Jupiterit
- 37. I ka tek Luani.
- 38. Boldi komik italian.
- 42. Eshhtë kolana në filma
- 43. Kush e thotë lutet.
- 44. Oxa këngëtare.
- 46. Inicialet e Nolte aktor.
- 47. Eshhtë tokë që... fitohet.
- 48. Një... gjermane.

VERTIKAL


- 1. Një votë në favor.
- 2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- 3. Në hyrje makinës.
- 4. Fillojnë lehtë.
- 5. Irlanda në Dublin.
- 6. Eshhtë edhe ajo e historisë.
- 7. Një pjesë e gamiljeve
- 8. Notat pa kufij.
- 9. Ishin komitë.
- 10. Ka kryeqytet Islamabad.
- 12. Don... i Interpretuar nga Terence
- 13. Mbyllin aktet.
- 15. Janë përmasa.
- 18. Gjysma e lujjes.
- 19. Castellitto aktor.
- 20. Inicilat e Dalí, piktor.
- 21. Tanita këngëtare.
- 23. Eshhtë tryzni
- 24. Në hyrje të Europës.
- 25. Janë rrobat për t'u larë.
- 30. Bën mëza.
- 31. Moreau aktor.
- 32. Janë thika.
- 39. Një pjesë e satelitit.
- 40. Janë teke në sende.
- 41. Pak marramendëse.
- 42. I ka tek zdapi.
- 45. Inicialet e Nolte-s.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

			7	1	5		2	
			2		5		4	6
			8		9			7
							3	
1			9		4			
8	9		5					
			3	6		7		4
	4			7				3
							9	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	8	6	7	3	9	4	5	2
7	2	9	4	1	5	6	8	3
3	4	5	6	8	2	7	9	1
6	9	1	2	4	3	8	7	5
2	7	4	5	6	8	3	1	9
5	3	8	9	7	1	2	6	4
8	6	3	1	9	4	5	2	7
9	5	7	3	2	6	1	4	8
4	1	2	8	5	7	9	3	6

Argëtim filozofik

- Gjuha e memecit është më e mirë se e gënjeshartit.
- Gjuha është dëshmitari gënjeshhtar i zemrës.
- Çfarëdo mendon të bësh, apo e ke ëndërr, filloje. Guximi ka gjenialitet, pushtet dhe magji brenda.
- Njerëzit përçmojnë atë që s'e kuptojnë.
- Pasuria është diçka që mund të ndihmojë në jetë, por jeta nuk është diçka që kalohet për të grumbulluar para.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	K	1	A	12	F	3	E		2	1	6	3	10	2
1	9	1	8					11	1	12		2	3	7
3	2	2			13	3	11	1	2	4	2	4		
3	2			13	3	7	3	2	4	5	3			
15		5	9	8	4	2	3	2	3	2				
9		3	5	4	11	3	2		2		12			
7	4	5		10	3	2		2	1	11	1			
4		9		15	16			17	2	4	6			
5	1		17	20	4	10	15			17	6			
3	9			11	1	2	3	10	2	1	2			
10	1			19	3			18	7	1	2			
1	19	8	4			11	4	7	1	2	4			

- Sjelljet e një njeriu janë një pasqyrë ku ai e sheh portretin e vet.
- Njeriu fisnik i bën për vete njerëzit fisnikë, dhe di si të mbështetet tek ata.

Thënie të mençura

- Nuk ka gjë më të frikshme se injoranca në veprim.
- Idetë e guximshme janë si lëvizjet e shahistëve që mund të sjellin humbjen e lojës, por krijojnë rastin për të filluar një lojë të re, e cila mund të fitohet.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQIJE TË NUMRIT TË KALUAR

S	A	R	A	B	A	D	P	L	A			
A	D	D	E	S	I	D	E	R	I	U	S	
T	E	B	U	R	I	D	A	N	I	I	K	
R	R	A	H	A	R	A	K	I	R	I	E	
A	P	I	T	O	N	I	H	D	A	N	A	E
H	A	S	I	M	U	R	I	A	L	T		
S	U	S	P	A	R	T	I	D	I	L		
A	I	F	A	R	I	S	E	J	T	E		
G	J	A	K	U	Y	P	R	O	T	E	U	
K	I	N	I	N	A	P	R	O	T	E	U	
T	D	E	D	I	T	H	S	A				
C	L	A	U	D	E	K	N	G	O	L		
S	A	G	A	N	G	A	N	I	M	E	D	I
L	A	R	K	A	M	I	K	A	Z	E		
O	K	A	K	L	A	S	I	O	M	A	R	A
K	E	R	A	S	A	K	U	V	L	I	K	A
A	R	O	S	A	K	T	E	T	M			
L	O	B	T	N	R	A	T	E	A			
N	I	C	O	T	A	H	E	R	O	I		
S	T	A	U	I	P	O	N	K				
P	I	S	T	A	M	O	S	T	I	E		
Y	A	R	D	E	M	E	T	R	A			

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

